



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE

Tema e magjistraturës:

**SFIDAT E INTEGRIMIT TË TIK-UT NË MËSIMDHËNIE DHE MËSIMNXËNIE
(RAST STUDIMI: GJIMNAZI “XHELAL HAJDA –TONI“ NË RAHOVEC)**

Kandidati:

Beqir Mustafa

Mentori:

Prof. dr. Artan Luma

Tetovë, 2018

PËRKUSHTIMI

Është shumë normale që ta punoj një tezë të masterit duhet kohë dhe angazhim i jashtëzakonshëm. Ky angazhim nuk do të bëhej pa ndihmën e atyre që më përkrahën që nga fillimi e deri në fund, prandaj shpreh mirënjohje ndaj kolegëve që shpenzuan kohën e tyre për të ofruar ndihmë. Gjithashtu më ka dhënë kurajë dhe mbështetje për çdo paqartësi dhe kërkesë nga ana ime. Një falënderim edhe për anëtarët e komisionit për këshillat e tyre të çmuara në finalizimin e këtij punimi.

Një falënderim i veçantë për stafin e shkëlqyer të arsimtarëve dhe stafin administrativ të Gjimnazit “Xhelal Hajda –Toni” në Rahovec ku unë punoj për përkrahje të pakursyer gjatë procesit të hulumtimit.

Ky punim ka për qëllim që njohuritë e fituara në fakultet gjatë studimeve, si dhe me punimin e kësaj teme t’i praktikoj në procesin mësimor.

Në fund, falënderoj edhe familjen time për përkrahjen morale që ma ofroi gjatë punimit të temës.

DEKLARATA E ORIGJINALITETIT

Përmes kësaj deklarate vërtetoj se unë jam autori i këtij punimi. Ky punim, nuk është prezantuar asnjëherë para ndonjë institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është botuar asnjëherë. Materialet të marra nga autorë tjerë, janë të cituara.

©Beqir Mustafa

Tetovë, 2018

REZYME

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimeve, apo TIK-u, siç quhet shkurtimisht, është duke u zhvilluar me hapa të shpejtë dhe se sot është vështirë të parashikohet se në çfarë niveli do të jetë kjo teknologji në 10 vjetët e ardhshëm dhe cili do të jetë ndikimi i saj në fushat e ndryshme të veprimtarisë njerëzore, siç ka qenë vështirë të parashikohet zhvillimi i sotëm i saj para dhjetë vjetësh [Caka, 2004].

Hulumtimi i këtij punimi ka të bëjë me identifikimin e nevojave për integrimin e TIK-ut në SHML-Gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec. Në këtë kontekst synuam të analizojmë në hollësi sfidat e integritit të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie, cili është niveli i infrastrukturës, çfarë lloji të pajisjeve posedon shkolla, në çfarë gjendje janë ato, si realizohet mirëmbajtja dhe aspekte tjera.

Kjo temë u realizua përmes metodës empirike, me ç’rast kemi përdorur të dhëna sasiore (pyetësorë me mësimdhënës) dhe cilësore (intervistë me drejtorin e DKA – Rahovec, me drejtorin e shkollës “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec, me sekretarin e kësaj shkolle si dhe me drejtorin e shkollës “Sami Frashëri” në Prishtinë). Përveç metodës empirike, kemi përdorë edhe metodën krahasuese, me ç’rast kemi bërë krahasim të procesit të integritit të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie të gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec me gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë.

Fjalë kyçe: TIK, Internet, Shkollë, Mësimdhënie, Mësimnxënie, Cilësi, Sfidë.

PËRMBAJTJA

PËRKUSHTIMI.....	2
DEKLARATA E ORIGJINALITETIT.....	3
REZYME.....	4
PËRMBAJTA.....	5
KAPITULLI I.....	7
1. HYRJE.....	7
1.1. Hyrje.....	7
1.2. Përcaktimi i problemit.....	7
1.3. Qëllimi.....	9
1.4. Objektivat.....	9
1.5. Hipotezat.....	10
1.6. Struktura e punimit.....	10
1.7. Rëndësia e studimit.....	11
KAPITULLI II.....	12
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	12
2.1. Integrimi i TIK në Mësimdhënie dhe Mësimnxënie.....	12
2.2. Sfidat për përdorimin e TIK-ut në klasë.....	13
2.3. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie.....	15
2.4. Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut.....	16
2.5. Sfidat me të cilat ballafaqohen shkollat në Kosovë në punët e përditshme.....	17
2.6. Reforma e TIK-ut në nivelin e arsimit të mesëm të lartë.....	18
2.7. Kushtet për zhvillimin e TIK-ut.....	21
2.8. Zhvillimi i burimeve njerëzore të TIK-ut.....	24
KAPITULLI III.....	27
3. METODOLOGJIA.....	27
3.1. Metoda.....	27
3.2. Popullata dhe kampioni i zgjedhur.....	27
3.3. Instrumenti.....	28

3.4. Procedura.....	28
3.5. Analiza e të dhënave.....	28
KAPITULLI IV.....	29
4. DIZAJNIMI I PYETËSORIT DHE UDHËZUESIT TË INTERVISTAVE	29
4.1. Ndërtimi i pyetësit.....	29
4.2. Ndërtimi i udhëzuesit të intervistës.....	30
4.3. Konkluzionet e pyetësorëve dhe udhëzuesit të intervistave.....	30
KAPITULLI V.....	31
5. REZULTATET E HULUMTIMIT.....	31
5.1. Të dhëna demografike.....	31
5.2. Të dhëna rreth aplikimit të TIK-ut në sistemin e mësimdhënies dhe burimeve njerëzore.....	33
5.3. Informata për qasjen në Internet dhe shfrytëzim të tij.....	41
5.4. Gjetjet cilësore të studimit.....	43
5.5. Analiza e korrelacionit.....	43
KAPITULLI VI.....	45
6. DISKUTIME.....	45
6.1. Diskutime lidhur me gjetjet empirike të studimit.....	45
6.2. Krahasim i rezultateve të punimit me rezultatet e hulumtimit me shkollë tjetër....	46
6.3. Analizë krahasuese.....	48
6.4. Testimi i hipotezave.....	49
6.5. Validiteti i studimit.....	50
7. KONKLuzionET.....	51
8. REKOMANDIMET.....	52
9. BIBLIOGRAFIA.....	53
10. SHTOJCA 1. PYETËSOR.....	59
11. SHTOJCA 2. UDHËZUES INTERVISTE.....	63
12. SHTOJCA 3. DEKLARATA E LEKTORIT.....	64
13. SHTOJCA 4. LEJA NGA DKA –RAHOVEC.....	65

KAPITULLI I

HYRJE

1.1. Hyrje

Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimeve, apo TIK-u, siç quhet shkurtimisht, është duke u zhvilluar me hapa të mëdhenj dhe se sot është vështirë të parashikohet se në çfarë niveli do të jetë kjo teknologji në 10 vjetët e ardhshëm dhe cili do të jetë ndikimi i saj në fushat e ndryshme të veprimtarisë njerëzore, siç ka qenë vështirë të parashikohet zhvillimi i sotëm i saj para dhjetë vjetësh [Caka, 2004].

1.2. Përcaktimi i problemit

Dihet mirëfilli se Teknologjia Informative dhe e Komunikimit është mjaft e rëndësishme në procesin arsimor. Mirëpo, në anën tjetër ekzistojnë disa sfida të cilat pengojnë integrimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie në shkolla. Mungesa e pajisjeve teknologjike (kompjuterë, laptopë, projektor, etj), fondi shumë i ulët i orëve mësimore të kësaj lënde tek nxënësit, mungesa e kabineteve të TIK-ut konform numrit të nxënësve të shkollës, mungesa e literaturës adekuate për TIK, janë disa nga sfidat të cilat pengojnë integrimin e TIK-ut në shkolla.

Sfidat që paraqiten gjatë procesit të integrit të TIK-ut në shkolla janë edhe të natyrave të tjera, për shembull, mësimdhënësit e kësaj lënde me përgatitje shkollore jo adekuate, mungesa e njohurive të mjaftueshme të gjuhës angleze, si për mësimdhënësit ashtu edhe për nxënësit, etj. Qëllimi i këtij punimi është të gjendet se cilët faktorë ndikojnë dhe shihen si më të rëndësishëm në integrimin e aplikimin e TIK-ut në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhelal Hajda –Toni” – Rahovec si dhe cilat janë sfidat konkrete që paraqiten gjatë këtij procesi.

Kjo shkollë, me gjithsej 950 nxënës, posedon 4 mësimdhënës të TIK-ut, njëri prej të cilëve është me përgatitje shkollore Baçelor i Informatikës, ndërsa të tjerët janë njëri me përgatitje Baçelor i Elektroteknikës dhe një Master i Makinerisë. Konsiderohet se këta mësimdhënës të TIK-ut, kanë njohuri bazike për TIK-un, por nuk janë kompetentë të mirëfilltë dhe që njohin këtë fushë në mënyrë profesionale. Kjo është si pasojë se

njohësit e mirëfilltë të kësaj fushe konsiderohen të jenë kuadro deficitare dhe kërkesa e tyre në tregun e punës është mjaft e madhe.

Shkolla ka vetëm një kabinet të TIK-ut, i cili përdoret vetëm për lëndën e TIK-ut dhe jo për qëllime të tjera. Hapësira kohore është e limituar për secilën klasë, kështu që nuk konsiderohet që është e mjaftueshme për numrin e nxënësve në shkollë. Prandaj nxënësit, përveç orëve të TIK-ut që i kanë vetëm dy herë në javë, ata nuk kanë mundësi që t'i qasen këtij kabineti edhe herëve të tjera. Kjo nënkupton se kabineti i TIK-ut është i dedikuar vetëm për këtë lëndë, andaj mësimitdhënësit e lëndëve të tjera nuk kanë asnjë mundësi që orët e tyre mësimore t'i mbajnë në kabinet të TIK-ut. Përveç lëndës së TIK-ut, asnjë lëndë tjetër nuk mbahet në këtë kabinet, prandaj kjo konsiderohet si një sfidë e pashmangshme drejt integritit të TIK-ut në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie në Gjimnazin "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec.

Shkolla posedon 32 kompjuterë (Pentium 4), 28 prej të cilëve janë në gjendje të rregullt, ndërsa 4 janë jashtë funksionit. Prej tyre, 26 përdoren nga nxënësit, ndërsa dy nga drejtoria. Kjo nënkupton se për mësimitdhënës nuk ka asnjë kompjuter. Nga kjo shihet qartë se shkolla i ka mundësitë e kufizuara që të përdorë aplikacione moderne për mësimitdhënie ngaqë mungojnë kushtet elementare. Mësimitdhënësit e lëndëve të tjera e kanë të pamundur të përdorin kompjuterin dhe veglat e TIK-ut për mësimitdhënie, çfarë dëshmon qartë se aplikimi i TIK-ut në mësimitdhënie është i kushtëzuar me pajisje të TIK-ut, e pasi që këto mungojnë atëherë kjo shkollë nuk është në gjendje që t'u ofrojë mësimitdhënësve pajisje të tilla për t'i realizuar orët e tyre me pajisje kompjuterike.

Po ashtu është me rëndësi të theksohet se shkolla nuk ka qasje në internet. *Wirelessi* ofrohet vetëm për administratë, ndërsa nxënësit nuk e përdorin kurrë ose shumë rrallë internetit, ata kryesisht kyçen në internet me 3G (Celularë individualë). Prandaj, si sfidë e paevitueshme e integritit të TIK-ut në Gjimnazin "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, konsiderohet edhe mosqasja në internet për nxënësit e kësaj shkolle. Edhe ata pak kompjuterë që janë në dispozicion, nuk janë të lidhur me internet. Prandaj nxënësit në lëndën e TIK-ut janë vetëm dëgjues pasivë pasi që asnjë njohuri që ka të bëjë me teknologjinë informative nuk mund ta praktikojnë në shkollë, përkatësisht në kabinet.

Nga kjo shihet qartë se shkolla nuk posedon kushte elementare për përdorim të TIK-ut në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie.

Prandaj, është e domosdoshme që, përmes këtij studimi, të identifikohen se cilat janë shkaqet që kanë stagnuar këtë proces, të identifikohen raportet që ekzistojnë ndërmjet motivimit të brendshëm dhe të jashtëm të stafit menaxherial por edhe të mësimitdhënësve, si dhe rolin e vetë efikasitetit të mësimitdhënësve dhe nxënësve në dëshirën për cilësi në integrimin e TIK-ut në shkollë.

Këto raporte përfshijnë vullnetin individual të stafit menaxherial dhe mësimitdhënësve për ta integruar TIK-un në shkollë në njërin anë si dhe angazhimin dhe përkushtimin e tyre për ta realizuar këtë, në anën tjetër.

1.3. Qëllimi

Hulumtimi i këtij punimi ka të bëjë me identifikimin e nevojave për integrimin e TIK-ut në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec. Në këtë kontekst synohet të analizohen në hollësi sfidat e integrimit të TIK-ut në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie, cili është niveli i infrastrukturës, çfarë lloji të pajisjeve posedon shkolla, në çfarë gjendje janë ato, si realizohet mirëmbajtja dhe aspekte tjera.

Një pjesë e këtij studimit i dedikohet edhe mësimitdhënësve të angazhuar në lëmin e TIK-ut në këtë shkollë. E themi këtë pasi që janë faktor kyç për ecurinë e proceseve të integrimit të TIK-ut në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie. Në këtë pjesë janë mbledhur edhe informacione rreth nivelit të aftësisë së tyre, trajnimit të ofruar nga ECDL si dhe nevojat për trajnime në fushën e TIK-ut.

Studimi ka për qëllim të mbledhë të dhëna të rëndësishme rreth aplikimit të TIK-ut në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec, si dhe të identifikohen sfidat dhe përparësitë që posedon shkolla me qëllim të rritjes së motivimit dhe efikasitetit të punës në fushën e TIK-ut.

1.4. Objektivat

Objektivat e këtij studimi janë:

- Të shqyrtohet literatura bashkëkohore vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me temën;
- Të identifikohen sfidat e integritit të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- Të analizohet niveli i infrastrukturës së TIK-ut në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhelal Hajda –Toni” në Rahovec;
- Të evidentohen mekanizmat për tejkalimin e sfidave të integritit të TIK-ut në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

1.5. Hipotezat

Hipotezat e parashtruara në këtë studim janë:

H1. Motivimi i arsimtarëve për shfrytëzimin e TIK-ut është një katalizator i rëndësishëm për ngritjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

H2. Stafi mësimor nuk është i përgatitur në nivel të duhur për shfrytëzimin e TIK-ut.

H3. Shfrytëzimi i TIK-ut varet kryesisht nga infrastruktura teknologjike që e posedon shkolla.

H4. Zbatimi i suksesshëm i TIK –ut varet nga mundësia për qasje në internet në shkollë.

1.6. Struktura e punimit

Ky punim është i strukturuar në gjashtë kapituj, të ndarë në nënkapituj, të cilave u paraprin : Përkushtimi, Deklarata e Origjinaliteti si dhe Rezymeja.

Në kapitullin e parë – HYRJE, kemi paraqitur kuptimin dhe rëndësinë e TIK-ut, qëllimin, objektivat, hipotezat, strukturën e punimit si dhe rëndësinë e saj.

Kapitulli i dytë - SHQYRTIMI I LITERATURËS, pasqyron politikat e sektorit të TIK-ut të Qeverisë së Kosovës, sfidat me të cilat ballafaqohen shkollat në punët e përditshme, reformën e TIK-ut në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, krijimi i një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e burimeve njerëzore (përdoruesit e produkteve të TIK -ut dhe ata që i prodhojnë këto produkte të TIK-ut) në fushën e TIK-ut në funksion të zhvillimit

të qëndrueshëm të arsimit. Në këtë kapitull kemi paraqitur po ashtu mendime të ndryshme të hulumtuara nga revistat shkencore ndërkombëtare lidhur me këtë temë.

Në kapitullin e tretë - ASPEKTE METODOLOGJIKE, përshkruhet metoda e përdorur në këtë punim, popullata dhe kampioni i zgjedhur, instrumenti, procedura si dhe analiza e të dhënave.

Në kapitullin e pestë - DIZAJNIMI I PYETËSORIT DHE UDHËZUESIT TË INTERVISTAVE, kemi paraqitur hapat e zhvillimit të pyetësit dhe udhëzuesit të intervistave si dhe kemi sqaruar validitetin e tyre.

Kapitulli i pestë - REZULTATET E HULUMTIMIT, përfshin të dhënat demografike për të anketuarit, të dhënat rreth aplikimit të TIK-ut në sistemin e mësimdhënies dhe burimeve njerëzore, të dhënat për Infrastrukturën e TIK-ut në shkollë si dhe informatat për qasjen në Internet dhe shfrytëzim të tij.

Në kapitullin e gjashtë dhe të fundit – DISKUTIME, kemi diskutuar dhe analizuar gjetjet empirike të studimit, cilësoret dhe sasioret, kemi bërë testimin e hipotezave si dhe validitetin e studimit. Punimi përmbyllet me konkluzione, rekomandime dhe bibliografinë.

1.7. Rëndësia e studimit

Rëndësia e këtij hulumtimi është një ide orientues ose udhëzuese drejt realizimit të tij në praktikë të hulumtimit. Poashtu ka të bëjë me faktin se nëpërmjet intervistave të bëra me drejtorët e dy shkollave si dhe me nxënës dhe profesorë kam marr informacione konkrete dhe reale në lidhje integrimin e TIK në procesin mësimor sa janë të motivuar që ta praktikojnë në lëndët e tyre .

Mendoj se ky studim ka një rëndësi të madhe pasi që ofron një pasuri informacionesh të cilat ndihmojnë në praktikën e integrimin të TIK-ut në shkollën ku unë punoj në veçanti dhe në arsimin kosovar në përgjithësi. Nëse qëllimi është i përcaktuar drejtë, hipotezat që do të verifikohen janë gjithashtu të realizueshme. Qëllimi i hulumtimit është të përcaktojë nivelin e pranisë së TIK në arsim nga mësuesit, si dhe investimet materiale nga drejtori i shkollës.

KAPITULLI II

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1. Integrimi i TIK në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie nuk është një metodë; por është një medium në të cilin mund të zbatohen një sërë metodash, qasjesh dhe filozofi pedagogjike [Garret, 1991]. Kjo tregon se efektiviteti i TIK-ut varet nga mënyra se si dhe pse aplikohet dhe integrohet. Në vitin 1980, Taylor deklaroi se përdorimi i TIK-ut është klasifikuar si mësues, si mjet dhe si nxënës [Taylor, 1980].

Programet aplikative mësimore i nxisin nxënësit që hap pas hapi të mësojnë përmes një programi mësimor siç janë ushtrimet dhe praktikat. Përdorimi i teknologjisë si mjet mund të ndihmojë identifikimin e problemeve tjera, për shembull, teknologjia si një mjet i konkretizimit shihet shpesh në programet e mësimdhënies ose edhe të shpjegimit [Means, 1993].

Teknologjia është një mënyrë ndryshe e prezantimit të mësimdhënies, ajo është një sistem nëpërmjet të cilit informacioni prezantohet. Teknologjia, si pjesë e teorisë konstruktiviste të mësimdhënies, është korniza e metodologjisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies e cila siguron aftësitë për të përkrahur të gjitha format kryesore të kësaj teorie. Mësuesit e përdorin teknologjinë e komunikimit për të nxitur shkëmbimet e informacionit me dhe ndërmjet nxënësve, për të përmirësuar mësimdhënien dhe nxënien dhe për të nxitur mësimin bashkëveprues.[IZHA,2015].

Një numër i mjeteve dhe aplikacioneve të ndryshme të TIK-ut mund të integrohen në mësimdhënie dhe mësimnxënie [Yunus, 2009].

Disa nga këto mjete dhe aplikacione mund të jenë të dizajnuara posaçërisht për qëllime edukimi dhe disa të tjera për përdorim më të përgjithshëm. Zgjedhja e burimeve dhe mënyra se si ato përdoren mund të lidhen me teoritë e ndryshme të të mësuarit të cilat mund të thirren për të shpjeguar ose parashikuar përfitime të të mësuarit nga përdorimi i TIK-ut [Wishart, 1999].

Roblyer dhe Edwards (2000) besojnë se përdorimi i TIK në arsim ka evoluar nga dy qasje themelore, përkatësisht nga metoda konstruktiviste dhe direktivizmi. Ana teorike e direktivizmit është bazuar në teoritë e bihevizmit dhe teorisë së përpunimit të

informacionit, kjo e fundit është një degë e psikologjisë kognitive. Përderisa ana teorike e konstruktivizmit është bazuar në principet e të mësuarit rrjedhimisht nga teoria e të mësuarit kognitiv.

2.2. Sfidat për përdorimin e TIK-ut në klasë

Procesi i përdorimit të TIK-ut në arsimin e përditshëm është shumë i komplikuar. Mundësitë e ofruara nga TIK-u për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxëniet nuk janë pa sfida. Mundësitë pothuajse të pafundme të qasjes në informata në një kontekst arsimor mund të përbëjnë një rrezik të vërtetë të mbingarkesës së informacionit nëse mësimdhënësit nuk kanë aftësi në filtrimin e informacionit për rëndësinë, ose nuk janë në gjendje të krijojnë një parim koherent organizues. Edhe nxënësit edhe mësimdhënësit mund të kenë mungesë të aftësive të domosdoshme për qasje, përpunim dhe përdorim të informacionit [Yunus, 2009].

Ka edhe një numër vështirësish që veprojnë si barriera dhe parandalojnë mësuesit që të integrojnë TIK në klasë. Siç përcakton Schoepp, një pengesë konsiderohet si çdo kusht që e bën të vështirë përparimin ose arritjen e një qëllimi [Schoepp, 2005].

Studiuesit kanë përdorur kategori të ndryshme për të klasifikuar sfidat për mësimdhënësit për të përdorur TIK-un në klasë. Disa studiues i kanë klasifikuar sfidat në dy kategori kryesore: sfida të jashtme dhe të brendshme. Ertmer iu referua sfidave të jashtme si renditje të parë dhe përmendi qasjen, kohën, mbështetjen, burimet dhe trajnimin, ndërsa si sfida të brendshme citoi qëndrimet, besimet, praktikat dhe rezistencën [Ertmer, 1999].

Al-Alwani përcaktoi sfidat e jashtme si sfida që lidhen me institucionet arsimore dhe jo me individët dhe sfidat e brendshme, që lidhen me mësimdhënësit, administratorët dhe individët [Al –Awani, 2005].

Disa hulumtues të tjerë grupuan sfidat në dy kategori të sfidave të nivelit të mësimdhënësve dhe sfidave në nivel shkolle. Becta klasifikoi sfidat në bazë të asaj se ata i referohen sfidave individuale (sfidave në nivelin e mësimdhënësve), siç janë mungesa e besimit, mungesa e kohës dhe rezistenca ndaj ndryshimit, ose sfidave institucionale

(sfida në nivel shkolle), siç është mungesa e trajnimeve efektive në zgjidhjen e problemeve teknike dhe mungesën e qasjes në burime [Becta, 2004].

Balanskat et al., i klasifikojnë ato në sfida mikro nivel, siç janë ato që lidhen me qëndrimet dhe qasjet e mësuesve për TIK-un dhe sfidat e mezo nivelit, siç janë ato që lidhen me kontekstin institucional [Balanskat, 2006]. Ata gjithashtu shtuan një grup të tretë të quajtur sfida makro nivel, të tilla si ato që lidhen me kuadrin më të gjerë arsimor. Përveç kësaj, një tjetër grup hulumtues i referohet sfidave si ato që kanë të bëjnë me dy lloje të kushteve: materiale dhe jo materiale.

Pelgrum konsideron se kushtet materiale i referohen numrit të pamjaftueshëm të kompjuterëve ose kopjeve të softuerit [Pelgrum, 2001]. Sfidat jo materiale i referohen njohurive dhe shkathtësive të pamjaftueshme të mësimit të TIK-ut, vështirësinë e integritit të TIK-ut në mësimit dhe kohës së pamjaftueshme të mësimit. Në Shtetet e Bashkuara, pengesat më të rëndësishme për përdorimin e TIK nga mësimit të shkollave të mesme ishin numri i pamjaftueshëm i kompjuterëve, mungesa e kohës së lirë për mësimit dhe mungesa e kohës në klasë për nxënësit të përdorin kompjuterët [Smerdon, 2000].

Mësimit në shkollat e mëdha dhe shkollat e qytetit kishin më shumë gjasa të raportnin mungesën e kompjuterëve si një pengesë ndërsa mësimit në shkollat me popullsi të lartë të nxënësve kishin më shumë gjasa të raportnin kompjuterë të vjetruar dhe jo të besueshëm si një pengesë [Smerdon, 2000].

Në një studim në Mbretërinë e Bashkuar, Jones raportoi se mungesa e besimit personal dhe qasja e pamjaftueshme në burimet e TIK-ut ishin sfidat kryesore për shumicën e mësimit të anketuar [Jones, 2004].

Disa nga faktorët e tjerë që ishin sfida të brendshme për mësimit, të tilla si rezistenca ndaj ndryshimeve dhe mungesa e vetëdijes për përfitimet e TIK-ut për të mësuar, janë raportuar në studimin e Jones. Në Zelandën e Re, mungesa e kohës për zhvillim profesional për të mësuar rreth teknologjive të reja dhe mungesa e kohës për të eksploruar teknologji të tilla si interneti dhe shërbimet e rrjeteve shoqërore u raportuan vazhdimisht nga mësimit si pengesa të rëndësishme për përdorimin e TIK-ut në klasë [Bilowes, 2001].

2.3. Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe integrimi i TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie

Ministra e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, më tutje e cituar si MASHT, ka hartuar draft strategjinë për mësimin elektronik dhe ka bërë pajisjen e shkollave me mjete dhe pajisje të ndryshme mësimore. Një numër i konsiderueshëm i shkollave në Kosovë janë pajisur me kompjuterë, projektorë, pajisje për kabinete të ndryshme, si dhe mjete të tjera që mundësojnë zhvillimin e kompetencave të nxënësve. Statistikat e MASHT-it tregojnë se 44.4% e shkollave kanë pajisjet për teknologji të informacionit dhe të komunikimit [Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, 2016].

Prandaj integrimi i TIK në mësimdhënie dhe nxënie nënkupton përdorimin e kompjuterëve dhe aplikacioneve kompjuterike në mënyrë produktive, shfrytëzimin e internetit dhe përdorimin e rrjeteve kompjuterike për qëllime të mësimdhënies dhe të mësimdhënxënies. MASHT, duke u mbështetur në prirjet globale të jetës dhe të arsimit të sotëm, si dhe në kompetencat evropiane për arsimin, ka vendosur si prioritet integrimin e TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimdhënxënie. Aplikimi i TIK-ut në mësimdhënie, ofron përfitime të mëdha për nxënësit dhe rrit aftësitë konceptuese dhe perceptuese të tyre gjatë orës së mësimin duke lehtësuar të nxënit. TIK-u sjell dinamizëm në mësimdhënie dhe mësimdhënxënie dhe i vendos nxënësit në kontroll për të nxënit e tyre, duke lejuar progres zhvillimi të pavarur.

Pajisja e shkollave me kompjuterë ndikon në masë të madhe në përdorimin e drejtë të tij. Mësimdhënësit gjatë orëve mësimore me udhëzime të tyre dhe me këshilla konkrete kanë mundësi t'i orientojnë nxënësit në përdorimin e drejtë të kompjuterit. Por jo të gjitha shkollat e kanë një mundësi të këtillë. Megjithatë, pavarësisht kësaj, mësimdhënësit mund të gjejnë mënyra të ndryshme për integrimin e teknologjisë si mjet pune për nevojat arsimore, qoftë me përdorimin e pajisjeve të tyre personale si laptop, ipad, apo me shfrytëzimin e pajisjeve të kolegëve të tyre e në disa raste edhe kur vetë nxënësit sjellin në shkollë laptopat e tyre. Shpenzimi i kohës së nxënësve duke keqpërdorur kompjuterin për komunikim dhe lojëra të ndryshme mund të shndërrohet në përdorim efektiv të tij në qoftëse mësimdhënësit e integrojnë TIK-un në procesin e të nxënit, duke i udhëzuar nxënësit që të hulumtojnë për nevojat e tyre mësimore të

përshtatura në kurrikulën e tyre lëndore. [A.Mexhnuani, Integrimi i Tik në mësimdhënie dhe nxënie,2015].

Në këtë kontekst, MASHT-i në bashkëpunim me donatorët ka punuar në zhvillimin e burimeve njerëzore duke ofruar trajnime në ECDL (European Computer Driving Licence).Gjithashtu, progres i konsiderueshëm është arritur në investimet infrastrukturore të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e situatës.

Megjithatë, problemi i mirëmbajtjes së dobët të pajisjeve të TIK-ut vazhdon të mbetet. Për më tepër, përkundër investimeve, numri i mësimdhënësve që janë të aftë të përgatisin përmbajtje elektronike dhe të përdorin ato në procesin mësimor është shumë i kufizuar [Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021, 2016].

2.4. Zhvillimi i infrastrukturës së TIK-ut

Sot është shumë vështirë të paramendohet jeta pa teknologji informative. Të gjitha segmentet e jetës, siç janë e ardhmja e aktiviteteve ekonomike, sociale dhe aktiviteteve tjera, janë të paimagjinueshme pa përdorim të internetit. Këtu nuk bën përjashtim as procesi arsimor (mësimdhënia e mësimnxënia). Në gjimnazin “Xhelal Hajda –Toni” në Rahovec, ky proces nuk duket se po ecën në drejtim të duhur ngaqë po mungojnë kushtet elementare për ta çuar përpara apo për ta zhvilluar teknologjinë informative.

Në Kosovë njerëzit lidhen në internet kryesisht përmes teknologjive pa tela (zona rurale), ndërsa numri i njerëzve që përdorin rrjetet ekzistuese të telave të bakrit të linjave telefonike është i limituar për shkak të mbulimit të ulët (vetëm në zona urbane) [Politikat E Sektorit Të Komunikimeve Elektronike – Axxhenda Dixhitale për Kosovën 2013 - 2020, 2013]. Ndërsa kjo lidhje e internetit nuk mund të aplikohet në gjimnazin “Xhelal Hajda –Toni” në Rahovec, kështu që në këtë segment kjo shkollë ka ngecë prapa.

Qeveria e Kosovës e ka për obligim të shqyrtojë mundësitë inovative për përdorimin e shërbimeve të internetit brez gjerë në shkolla dhe institucione të tjera akademike, institucione të shëndetit publik dhe institucione kulturore, siç janë bibliotekat. Prandaj, është me rëndësi që si pjesë e angazhimeve për realizimin e synimit të këtyre Politikave për sa i përket shtrirjes së infrastrukturës së komunikimeve elektronike të parashihen hapa konkret për arritjen e këtyre synimeve [Draft Strategjia për Mësimin Elektronik, 2011].

Është e domosdoshme që të ndërmerren hapa për zhvillim të sigurt të shoqërisë në fushën e informacionit duke rregulluar si duhet marrëdhëniet publike në këtë fushë. Është tejet e rëndësishme që të bëhen ndryshimet ligjore ashtu që sistemi aktual ligjor të mos jetë pengesë për përparimin teknologjik, por përkundrazi, të kontribuojë në të: ato duhet t'iu përshtaten marrëdhënieve ekzistuese publike dhe të ofrojnë mbrojtje adekuate për shfrytëzuesit, të rrisin besimin e tyre në teknologjitë e informacionit dhe të inkurajojnë përdorimin e ndërjegjësuar shoqërinë, në nivel nacional, lidhur me rreziqet potenciale në fushën e sigurisë së rrjeteve dhe informatave për eliminimin e këtyre rreziqeve, përfshirë mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet ilegale në hapësirën kibernetike [Politikat E Sektorit të Komunikimeve Elektronike – Axxhenda Dixhitale Për Kosovën 2013 - 2020, 2013].

2.5. Sfidat më të cilat ballafaqohen shkollat në Kosovë në punët e përditshme

Meqenëse teknologjia informative është dicka e re për arsimin në Kosovë, ajo po zhvillohet çdo ditë e më tepër në botë , këtu tek ne është e pamundur që shkollat të mos ballafaqohen me sfida të ndryshme lidhur me aplikimin e TIK-ut për mësimnxënie. Mirëpo, këtu nuk përjashtohen as mësimdhënësit të cilët ndoshta kanë njohuri të shkëlqyeshme për profesionin të cilin e zotërojnë por u mungojnë njohuritë e Teknologjisë Informative, gjë e cila ndikon në procesin e mësimdhënies.

Ndër sfidat më të shpeshta me të cilat ballafaqohen shkollat (mësimdhënësit dhe nxënësit) mund t'i veçojmë faktorët në vijim. Së pari, dihet mirëfilli se mungonjë fondet qeveritare për të investuar mjaftueshëm apo për të plotësuar të gjitha kapacitetet e nevojshme për shkollat e Kosovës. Edhe mungesa e infrastrukturës është një sfidë, me c'rast vlen përmendur kapacitetet e kufizuara të internetit në të gjitha shkollat e Kosovës. Sfidë tjetër, në këtë rast, konsiderohet edhe mungesa e motivimit dhe e përkrahjes për inkuadrimin e TIK-ut në procesin mësimor.

Duhet vënë në pah edhe faktin se mësimdhënësit (profesionistët et TIK), nuk gëzojnë përkrahje të mjaftueshme profesionale, që do të ndikonte drejtpërdrejtë në zhvillimin cilësor apo në integrimin e suksesshëm të TIK-ut në shkolla.

Është me rëndësi të vecantë të përmenden edhe faktorët ekonomikë, të cilët janë të lidhura me aftësimin e mësimdhënësve dhe nxënësve për integrimin e TIK-ut. Kjo ndërlikohet me kushtet ekonomike, ku ka shumë mësimdhënës ose nxënës që nuk kanë fare kompjuter në shtëpi, e mos të flasim për qasje në internet.

Duke pasur parasysh faktin se nxënësit kanë nevojë për përkrahje nga mësimdhënësit e tyre për të zhvilluar njohuri për TIK-un, kjo mundësi u është e kufizuar, pasi që edhe njohuritë e vet mësimdhënësve janë të kufizuara. Nuk duhet lënë anash aspak edhe faktorët etikë dhe ligjorë të cilët duhet të obligojnë si nxënësit ashtu edhe mësimdhënësit që programet dhe pajisjet kompjuterike t'i përdorin për qëllime aftësimi dhe edukimi.

Një sfidë tjetër, në këtë rast konsiderohet edhe problemi i faktorëve teknikë dhe të përkrahjes teknike për zgjidhjen e ndonjë problemi që mund të dalë gjatë përdorimit të TIK-ut. Mungesa e përkrahjes teknike, pengon zhvillim efektiv të njohurive të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Pra të gjithë këta faktorë që i përmendëm ndikojnë që mos të realizohet niveli i mjaftueshëm i përdorimit të TIK-ut në shkolla, e aq më pak të bëhet fjalë për mësimin online. Kjo vjen si pasojë e mungesës së burimeve financiare, e mosvënies në listë prioritare të zhvillimit të TIK-ut nga ana e krerëve institucionale e të tjera.

2.6. Reforma e TIK-ut në nivelin e arsimit të mesëm

Zhvillimet e reja teknologjike të bazuara në dije, kanë nxitur institucionet arsimore që të angazhohen në mënyrë maksimale për përgatitjen e gjeneratave të reja në këtë drejtim. Në veçanti, zhvillimet me ritme të shpejta në fushën e TIK-ut, kanë shtruar para institucioneve arsimore detyrën për arsimimin dhe aftësimin e vazhdueshëm të mësimdhënësve dhe të nxënësve.

Dihet se edukimi sot konsiderohet ndër shtyllat e zhvillimit ekonomik dhe rritjes së mirëqenies sociale. Sikurse konkurrenca ekonomike që po zhvillohet në nivel global me ritme të shpejta, ashtu edhe edukimi është shndërruar në një resurs të rëndësishëm të prioritetëve konkurruese duke u bërë një mjet mjaft i rëndësishëm për përfitimet afatgjata në vende të ndryshme, të cilat e konsiderojnë edukimin si një rrugë për të

reduktuar varfërinë, humbjet ekonomike dhe për të përmirësuar mirëqenien e qytetarëve.

Nxitur nga globalizimi i ekonomisë si dhe nga presioni i vazhdueshëm për të mësuar e trajnuar profesionistë të përgatitur, të aftë e konkurrues, institucionet arsimore në mbarë botën, sot ballafaqohen me sfidat e mëdha të rritjes të përmirësimit të cilësisë, në kushtet kur mjetet financiare janë të kufizuara dhe nuk përmbushin kërkesat e nevojshme. Ky synim global ka ndikimin edhe në institucionet arsimore në Kosovë.

Në realitetin e sotëm, institucionet arsimore janë nën presionin e shumë faktorëve, të cilat janë si me poshtë.

- Një numër i madh nxënësish që kanë formime, nevoja, motivime, aftësi, preferenca studimi, mundësi kohe dhe financiare, si dhe kërkesa të tjera nga më të ndryshmet;
- Një kërkesë për më shumë “klientë” bashkëveprues dhe programe fleksibël;
- Nevoja gjithnjë e në rritje për të përdorur TIK-un në proceset mësimore dhe administrative [UNESCO,2003].

Kohëve të fundit, revolucioni teknologjik është duke u zhvilluar në një pjesë të madhe të shteteve të botës, ku shoqëria po kalon nga një shoqëri e orientuara nga kushtet e jetesës së industrializimit në një shoqëri të orientuar drejt informacionit, ku krijueshmëria dhe dituria nxit dhe drejton shoqërinë (Bekteshi, 2016).

Një shoqëri e cila përdor teknologjinë e informacionit është në fakt një shoqëri e avancuar, shoqëri e orientuar drejt informacionit dhe njohurive në mënyrë që të maksimizojë të mësuarit, të stimulojë zgjuarsin dhe shpikje dhe të zhvillojë kapacitete [Hargreaves, 2003].

Që nga koha që integrimi i TIK-ut është futur në sektorin e edukimit, institucionet arsimore kanë hartuar projekte të ndryshme me qëllim që të rrisin numrin e përdoruesve të TIK-ut në procesin e edukimit.

Ndër aktivitetet kryesore në këtë proces vlen përmendur këto kushte:

- Pajisja e shkollave me kompjuterë dhe me rrjete kompjuterike, krijimi i kabineteve të TIK-ut;
- Futja e lëndës së TIK-ut në shkolla;

- Aftësimi profesional i mësimeve lidhur me aplikimin e TIK-ut (në rastin tonë është trajnimi ECDL).

Teknologjia e Informacionit tashmë është shndërruar në një faktor kyç në menaxhimin e shkollave, si faktor që mundëson mbështetje për procesin e mësimeve dhe mësuesit.

Studiuesi Crawford [1997], konsideron se përfundimet e nxjerra për përdorimin e teknologjisë së informacionit në edukim janë:

- TIK është një mësues interesant;
- TIK është gjithashtu një mësues i kujdesshëm dhe i përgjegjshëm;
- TIK mbështet të mësuarin e hapur, të pavarur dhe fleksibël;
- TIK u jep qasje në burime online të të mësuarit;
- TIK promovon shpërndarjen dhe bashkëpunimin;
- TIK promovon diversitetin dhe është kudo;
- TIK është i verbër ndaj gjinisë, racës, moshës dhe paaftësisë (Crawford, 1997)

Edhe Moonen dhe Kommers [1995], përshkruajnë funksionet e mëposhtme të përdorimit të TIK-ut në sektorin e edukimit :

- TIK si objekt - Kjo i referohet të lexuarit mbi TIK-un, që më shpesh është e organizuar në formën e kurseve specifike. Edukimi përgatitë nxënësit për përdorimin e TIK-ut në edukim, punësim në të ardhmen si dhe për jetën shoqërore.
- TIK si mjet ndihmës – TIK-u përdoret si një mjet për kryerjen e detyrave, grumbullimin e të dhënave dhe dokumentacionit, komunikimin dhe kryerjen e kërkimeve.
- TIK si një mjet për mësime dhe mësuesit - Kjo i referohet të parit të TIK-ut si një mjet për të mësimeve dhe nxënësin, si një mjet nëpërmjet të cilit mësimeve mund të japin mësime kurse nxënësit mund të marrin mësime.
- TIK si një mjet për organizimin dhe menaxhimin e shkollave dhe universiteteve [Moonen & Kommers, 1995].

Duderstat [1999] ka përvijuar një sërë reformash si rezultat i përdorimit të TIK-ut në shkolla. Këto reforma janë:

1. Sa i përket mënyrës së mësimdhënies dhe mësimnxënies, TIK-u ka sjellë reforma në mënyrën se si informacioni përcillet nga mësimdhënësi dhe merret nga nxënësit. TIK-u ofron mundësinë që nxënësit të lexojnë të njëjtin material në kohë të ndryshme dhe në vende të ndryshme. Ndërkohë, TIK-u ka sjellë edhe mënyrë të re të mësimdhënies.
2. Sa i përket qëllimit të edukimit, edukimi është trajtuar më parë vetëm në këndvështrimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, por integrimi i TIK-ut ka ndikuar që edukimi të perceptohet si një proces krijimi, kërkimi, ruajtjeje, integrimi, transmetimi dhe aplikimi të njohurive.
3. TIK është një mjet i fuqishëm, kjo në mënyrë të konsiderueshme vlerësohet në atë se çfarë mund të bëjnë njerëzit me TIK-un dhe duke e parë atë si një mjet mësimi veçanërisht të efektshëm [Duderstat, 1999].

Teknologjitë e reja në edukim janë kthyer në një çështje edukimi, një mundësi, një rrezik, një domosdoshmëri, të gjitha këto, për arsytet që kanë të bëjnë pak me një zgjedhje të qëllimshme nga edukatorët [Burbles & Callister, 2000].

Termi TIK - siç aplikohet në edukim, është teknologji që përfshin kompjuterët, Internetin, teknologjitë e transmetimit (radio dhe televizion), dhe telefonia të cilat lehtësojnë jo vetëm shpërndarjen e instruksioneve, por edhe vetë procesin e të mësuarit. Këto teknologji janë identifikuar si një mjet i rëndësishëm për realizimin e një strategjie të re të edukimit të orientuar tek lexuesit, që mbështet më mirë kërkesat e lexuesve nëpërmjet instruksioneve të personalizuara dhe të diferencuara [Watson & Watson 2011].

2.7. Kushtet për zhvillimin e TIK-ut

Për zhvillimin e TIK-ut, është e ditur se kjo teknologji kërkon kushte specifike për t'u zhvilluar dhe avancuar në një mjedis. Si kushte të domosdoshme të cilat duhet të përdoren për zhvillimin e TIK-ut, i kemi konsideruar këto kushte:

- a) Mjedi fizik i përshtatshëm dhe i nevojshëm për zhvillimin e TIK –ut;
- b) Zhvillim i TIK-ut dhe përcaktimi i standardeve;

- c) Sigurimi i rrjetit kompjuterik nëpër shkolla;
- d) Promovimi i zhvillimeve të shërbimeve elektronike – TIK nëpër shkolla.

a) Mjedisi fizik i përshtatshëm dhe i nevojshëm për zhvillimin e TIK –ut.

Nëse flasim për mjedis fizik të përshtatshëm dhe të nevojshëm për zhvillimin e TIK-ut, këtu nënkuptohet infrastruktura fizike, që do të përshtatet për të gjitha format e mësimi. Kush për zhvillimin e TIK-ut është krijimi i hapësirës fizike e cila do të ofronte kushte optimale për punë, për qasje të lehtë dhe mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit në implementimin e TIK-ut. Nisur nga kjo, mund të thuhet se mjedisi fizik është një nga parakushtet infrastrukturale për zhvillimin e TIK-ut. Në dallim nga mësimi tradicional pa integrim të TIK-ut, mësimi i sotëm kërkon kushte më specifike në disa aspekte, duke filluar nga klasat e kabinetet, që duhet të pajisen me orendi të tjera, për t'u shtrirë deri tek pajisja e tyre me rrymë dhe me rrjetin kompjuterik.

b) Zhvillim i TIK-ut dhe përcaktimi i standardeve.

Për nevojat e infrastrukturës së TIK-ut, parashikohet nevoja për krijimin e mjediseve fizike për aplikimin e TIK-ut. Këto kryesisht parashikojnë standardet për kabinetet kompjuterike, një varg rregullash për bankat të përshtatshme për kompjuter, orenditë dhe pajisjet e TIK-ut [Strategjia e Qeverisjes Elektronike 2009-2015, 2008].

Lidhur me këtë, do të ishte më mjaft interes nëse do të inicioheshin planet për rishikimin e hapësirave ekzistuese nëpër shkollat e AML të nevojshme për zbatimin e TIK-ut. Pastaj të bëhej një analizë se cilat hapësira mund të përshtaten më lehtë dhe më shpejt, për t'u përdorur për TIK. Prandaj konsiderohet e rrugës së të merren masa për përpilimin e raportit mbi gjendjen e hapësirave ekzistuese dhe projekt propozimi për përshtatjen e hapësirave sipas standardeve të TIK-ut në shkollat e AML-së në Kosovë.

Për nevoja të TIK-ut , mund të sigurohen hapësira duke i strukturuar qendrat e ndryshme jashtë shkollave dhe institucioneve shkollore, për shkak të karakterit fleksibil të TIK-ut. Në këtë rast, me rëndësi të posaçme është edhe furnizimi stabil dhe i vazhdueshëm me energji elektrike, pasi që mungesa e energjisë ndikon në ngecjen e zhvillimit të TIK-ut, ndërsa ndërprerja e rrymës në mënyrë të papritshme mund edhe t'i shkatërrojë pajisjet e TIK-ut të cilat janë në përdorim.

c) Sigurimi i rrjetit kompjuterik nëpër shkolla.

Kusht i domosdoshëm për aplikimin e TIK-ut në shkolla është që çdo shkollë të pajiset me rrjet kompjuteri. Në këtë rast mund të përdoren LAN (*Local Area Network*).

Meqë instalimi i rrjetit kompjuterik është i domosdoshëm, për ta realizuar këtë duhet plotësuar këto kritere:

- Krijimi i rrjetit LAN për kabinetet e TIK ;
- Kyçja e internetit në kabinetet e TIK-ut;
- Mirëmbajtja dhe kujdesi për pajisjet në kabinetet e TIK-ut;

d) Promovimi i zhvillimeve të shërbimeve elektronike –TIK nëpër shkolla.

Duke pasur parasysh faktin se interneti është bërë mjet i rëndësishëm për ofrimin e shërbimeve, pengesat për disa qytetarë që t’iu qasen këtyre shërbimeve çon në përjashtim social dhe ka ndikime negative ekonomike. Qeveria dhe MASHT-i po gjejnë mundësi të nevojshme për ti trajnuar arsimtarët për rritur njohuritë e tyre për kompjuterët dhe pajisjet e tjera të TIK-ut. Aftësia për të përdorur kompjuterët në mënyrë efektive është bërë pjesë thelbësore e edukimit të të gjithëve. Aftësitë si kontabiliteti dhe punët administrative, inventarizimi, e tjerë, tani përbëjnë një sërë praktikash kompjuterike që përbëjnë pakon kryesore të aftësive të TIK-ut.

Është e rëndësishme që shkollat vazhdimisht të rishikojnë rregulloret dhe procedurat e tyre në lidhje me përdorimin e internetit të pranueshëm, sigurinë në internet, identitetin digjital dhe mbrojtjen e të dhënave në kontekst të politikave të shkollës dhe planifikimit. Ekziston nevoja për të investuar në pajisjet digjitale në shkolla. Është identifikuar gjithashtu gjatë fazës së hulumtimit për strategjinë që shumë mësues do të donin qasje në një pajisje të TIK "si pjesë e mjeteve të tyre profesionale". Shumë shkolla tashmë kanë laptopë ose pajisje tabletë për mësuesit, në mënyrë që t'u mundësohet atyre të planifikojnë, zhvillojnë orën mësimore dhe të gjejnë burime shtesë për lëndën përkatëse. Niveli i të mësuarit online dhe burimeve që duhej t'u ofrohej nxënësve dhe aplikimit të shërbimeve të wireless pse jo në shkollës ishin dy çështje të veçanta të cilat u gjetën të jenë nënvlerësuar.

Përkundër sfidave, shkollat kanë raportuar rezultate pozitive, për integrimin e TIK-ut në shkollë. Ato kërkojnë këshilla për zbatimin e strategjive të tilla për të siguruar që këto pajisje të TIK-ut të mos keqpërdoren nga nxënësit.

TIK-u mund të ndihmojë në shpërndarjen e gjerë të informatave për kulturën e Kosovës dhe të kontribuojë në ruajtjen dhe fuqizimin e shumëllojshmërisë kulturore evropiane si dhe kultivimin e veçorive nacionale, për këtë duhet t'i kemi të përgatitura mirë edhe resurset njerëzore.

2.8. Zhvillimi i burimeve njerëzore të TIK-ut

Kur flitet për burimet njerëzore në fushën e TIK kemi parasysh dy kategori njerëzish: përdoruesit e produkteve të TIK -ut dhe prodhuesit e produkteve të TIK-ut. Qëllim i strategjisë për TIK, sa u përket burimeve njerëzore duhet të jetë ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të mjaftueshme dhe kompetente për përdorimin e produkteve të TIK-ut të cilët do të jenë të afta t'u përgjigjen kërkesave gjithnjë më të mëdha të së sotmes dhe të së nesërme në fushën e TIK-ut dhe të cilat do të jenë forcë shtyisë për një zhvillim ekonomik dhe shoqëror të qëndrueshëm të arsimit të Kosovës.

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë informative, pa dyshim se prekë ata që merren me mësimin e TIK-ut. Lidhur me këtë, institucionet vendimmarrëse duhet t'i japin prioritet zhvillimit të burimeve njerëzore që ata të zhvillohen në aspektin profesional dhe të motivohen për punë me të tjerët. Nga kjo mund të konstatohet se motivimi i stafit është ndër faktorët kyç të burimeve njerëzore. Krijimi i një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e burimeve njerëzore në fushën e TIK-ut e në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të Kosovës, si shoqëri demokratike që bazohet në shfrytëzimin e teknologjisë së informacionit. Nga psikologjia është e njohur se me nocionin motivim i arsimtarëve nënkuptohet sistemi i nxitjeve, shtytjeve apo i cjtjeve të aktiviteteve metodologjike, emocionale, sociale, motorike e kështu me radhë. Motivimi është faktori kryesor i mësimdhënies dhe nxitësi i cili e shton aktivitetin e nxënësve, interesimin dhe vullnetin e tyre për mësim.

Drejtori i shkollës është element shumë i rëndësishëm i organizimit dhe menaxhimit të jetës në shkollë dhe harmonisë që krijohet në të. Motivimi i duhur i drejtorit dhe përcjellja e këtij motivimi në hallkat e tjera të jetës së shkollës sigurisht që e çon shkollën

drejt suksesit, prandaj drejtori e rrit performancën e arsimitarit nëse e përdor TIK-un në mësimdhënie, i siguron projektor dhe laptop si hap i parë që t'i zbatojë metodat teknologjike. Arsimtari duhet të jetë plot motivim dhe energji që jo vetëm e zotëron por edhe e transmeton tek nxënësi. Ky motivim transmetohet tek nxënësi nëpërmjet formave të ndryshme: sjelljes, komunikimit, metodave, teknikave, mjeteve, shpërblimeve etj.

Objektivat e menaxhimit të burimeve njerëzore në lëmin TIK-ut janë:

- Burime njerëzore të afta për zbatimin e TIK-ut, në kategoritë përkatëse;
- Mësimdhënës të përkushtuar për krijimin dhe zbatimin e përmbajtjeve elektronike;
- Zhvillimi i njohurive dhe shkathtësive në TI dhe për gjuhën angleze (për përdorimin e Mësimin Elektronik) me qëllim të ngritjes dhe zhvillimit personal;
- Komunitet i organizuar i ekspertëve për ngritjen dhe zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme që ndjekin trendët e reja të Mësimin Elektronik [Shala-Bajrami, 2016].

Qëllimi i strategjisë për TIK, sa u përket burimeve njerëzore parashihet të jetë:

Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore të mjaftueshme dhe kompetente për përdorimin e produkteve të TIK-ut dhe për krijimin e produkteve të TIK-ut, të cilat do të jenë të afta t'u përgjigjen kërkesave gjithnjë më të mëdha të së sotmes dhe të së nesërme në fushën e TIK-ut dhe të cilat do të jenë forcë shtyese për një zhvillim ekonomik dhe shoqëror të qëndrueshëm të Kosovës [Caka, 2004].

Për përgatitjen e burimeve njerëzore për të zbatuar TIK-un duhet pasur parasysh këta faktorë:

- përzgjedhja dhe rekrutimi/ngritja e kapaciteteve njerëzore;
- orientimi i tyre, ku përfshihet, para së gjithash, përcaktimi i detyrave të tyre, metodat se si do të arrihen objektivat e përcaktuara;
- trajnimi dhe zhvillimi i tyre profesional në përputhje me standardet e përcaktuara për trajnim.

Këta faktorë ndikojnë në përgatitjen e kuadrove si dhe rrisin cilësinë e punës së stafit që ndikojnë drejtpërdrejt në organizim efektiv të punës si dhe për mbajtjen e motivit të lartë për punën.

Bazuar në kurrikulat e reja të Kosovës në arsimin fillor dhe të mesëm të Kosovës, është parashikuar edhe aftësimi adekuat i nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme në fushën e TIK-ut. Bie fjala, në arsimin fillor dhe të mesëm, në shkollat e të gjitha profileve, është futur si lëndë mësimore edhe lënda e TIK-ut, por rezultatet ende nuk janë të kënaqshme, sepse ende është:

- numri i vogël i kompjuterëve për kokë të nxënësit dhe përdorimi i vogël i Internetit për qëllime mësimore, për shkak të mungesës së buxhetit në shkolla.
- përqindja e vogël e nxënësve që përdorin kompjuterin dhe Internetin në kuadër të
- shkollës në procesin e mësimin jashtë Informatikës.
- niveli i kualifikimit të mësimitdhënësve në TIK në shumicën e rasteve është i trajnuar.
- përqindja e vogël e mësimitdhënësve (përfshirë ata të Informatikës) që përdorin Internetin për mësimitdhënie/mungesë e laptopëve.
- numri i nxënësve që regjistrohen në shkollat profesionale të profilit të TIK-ut ka qenë i pakët,por ka filluar të rritet.

KAPITULLI III

3. METODOLOGJIA

3.1. Metoda

Kjo temë u realizua përmes metodës empirike, me ç'rast kemi përdorur të dhëna sasiore (pyetësorë me mësimdhënës) dhe cilësore (intervista me drejtorin e DKA – Rahovec, me drejtorin e shkollës “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec, me sekretarin e kësaj shkolle si dhe me drejtorin e shkollës “Sami Frashëri” në Prishtinë). Përveç metodës empirike, kemi përdorë edhe metodën krahasuese, me ç'rast kemi bërë krahasim të procesit të integritit të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie në gjimnazin “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, si dhe Gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë.

Gjatë punimit të temës së magjistraturës kemi përdorë literaturë nga burime të ndryshme shkencore dhe të dhëna statistikore. Kemi përdorë literaturë vendore dhe të huaj, kryesisht botime të reja. Qëllimi i këtij punimi ishte të grumbullojë informacione për përdorimin e TIK-ut, në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec si dhe të krahasojë me ndonjë shkollë tjetër në Kosovë e cila është e zhvilluar përsa i përket integritit të TIK-ut në Mësimdhënie dhe mësimnxënie.

3.2. Popullata dhe kampioni i zgjedhur

Popullatë në këtë studim janë 45 mësimdhënës të Shkollës së Mesme të Lartë “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec. Pra, në procesin e hulumtimit janë përfshirë të gjithë mësimdhënësit, pa bërë asnjë përjashtim. Përveç mësimdhënësve (për nxjerrjen e të dhënave sasiore), popullatë në këtë studim konsiderohen edhe drejtorët e institucioneve arsimore (drejtori i DKA-së në Rahovec, drejtori i gjimnazit “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, drejtori i gjimnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë si dhe sekretari i gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec për nxjerrjen e të dhënave cilësore). Për pjesën cilësore të studimit, që lidhej me procesin e intervistimit, u përdor kampioni i qëllimshëm. Kampioni i qëllimshëm është një lloj i kampionit jo-probabilitar dhe zakonisht përdoret në hulumtimet me karakter cilësor që fokusohen në eksplorimin dhe interpretimin e përvojave dhe perceptimeve [Matthews dhe Ross, 2010].

3.3. Instrumenti

Instrument në këtë studim konsiderohet pyetësi i përgatitur për mësimdhënësit e Shkollës së Mesme të Lartë “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec, si dhe udhëzuesi i intervistës për drejtoreshën e DKA - në Rahovec, drejtoreshën e gjimnazit “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec, drejtorin e gjimnazit “Sami Frashëri në Prishtinë”, për sekretarin e gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni në Rahovec. Pyetësit u hartuan duke marrë si bazë titullin e punimit, qëllimin dhe hipotezat e këtij punimi.

3.4. Procedura

- Fillimisht u kërkua leje nga DKA – Rahovec për të më dhënë lejen për të zhvilluar anketat dhe intervistat në Shkollën e Mesme të Lartë “Xhelal Hajda – Toni” – Rahovec.
- Secili mësimdhënës, paraprakisht u informua lidhur me qëllimin e hulumtimit, dhe u garantua se të dhënat e pyetësit do të jenë anonime dhe nuk do të përdoren për qëllime të tjera por vetëm për temën e magjistraturës.
- Më pas, anketat dhe udhëzuesi u shpërndanë tek mësimdhënësit dhe te drejtorët e DKA-së, dy shkollave dhe sekretarit të shkollës. Ata u informuan paraprakisht për qëllimin e këtij hulumtimi.
- Koha për vet administrimin e pyetësit dhe udhëzuesit të intervistave ishte 15 - 20 minuta.

3.5. Analiza e të dhënave

Sa i përket analizës së të dhënave, të dhënat që i kemi mbledhur nga realizimi i anketave i kemi përpunuar dhe analizuar në aplikacionin Excel, ku më pas kemi bërë edhe gjenerimin e grafikoneve duke i nxjerrë rezultatet e gjetura me përqindje.

Të dhënat nga intervistat, janë analizuar dhe përpunuar pa ndonjë sistem elektronik pasi që ato janë përgjigje të pyetjeve të hapura ku të intervistuarit kanë shprehur mendimin e tyre lidhur me pyetjet e parashtruara në udhëzues interviste.

KAPITULLI IV

4. DIZAJNIMI I PYETËSORIT DHE UDHËZUESIT TË INTERVISTAVE

4.1. Ndërtimi i pyetëtorit

Për ndërtimin e pyetëtorit kryesisht jemi mbështetur në titullin e punimit, qëllimin dhe hipotezat e këtij punimi, kështu që çdo pyetje ka pasur lidhshmëri me temën që e hulumtuam. Pyetëtori i strukturuar që u përdor për mbledhjen e të dhënave përmban 3 pjesë.

Në pjesën e parë: *Të dhëna demografike dhe Informacione rreth aplikimit të TIK-ut në sistemin e mësimdhënies dhe burimeve njerëzore*, janë paraqitur 10 pyetje të strukturuar, të cilat synojnë të marrin të dhëna në lidhje me gjininë, moshën, pastaj të marrin një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së infrastrukturës së shkollës, nëse posedon shkolla plan (TIK) për zhvillimin e shkollës, në çfarë niveli të prioriteteve është identifikuar TIK-u në planin zhvillimor, për çfarë qëllimesh shfrytëzohen pajisjet e TIK-ut në shkollë, si vlerësohet domosdoshmëria për shkathtësitë e aplikimit të TIK-ut për mësimdhënësit dhe burimet tjera njerëzore në shkollë, a është e paraqitur mungesa e teksteve mësimore për lëndën e Informatikës, si vlerësohet shkëmbimi i përvojave dhe ofrimi i trajnimeve nga vetë stafi i shkollës (mësimdhënësit e Informatikës, apo edhe të tjerë me shkathtësi të TIK-ut) për kolegët e tyre në shkollë.

Pjesa e dytë: *Informata të përgjithshme për Infrastrukturën e TIK-ut në shkollë* ka si synim të mbledhë të dhëna në lidhje me infrastrukturën e TIK-ut në shkollën “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec. Kjo pjesë është përqendruar në atë se si vlerësohet inventari përcjellës i kabineteve të Informatikës (tavolinat, karriget, tabelat, etj.) dhe si vlerësohet instalimi elektrik i kabineteve të Informatikës.

Pjesa e tretë: *Informata për qasjen në Internet dhe shfrytëzim të tij*, ka si synim të evidentojë të dhënat se për çka shfrytëzohet interneti në shkollë, sa shpesh e përdorin nxënësit internetin në shkollë si dhe prej nga kyçen nxënësit në internet në shkollë.

4.2. Ndërtimi i udhëzuesit të intervistës

Udhëzuesi i intervistës përmbante pyetje të hapura e cila nuk u organizua në pjesë por vetëm në 17 pyetje të cilat tregojnë për numrin e nxënësve, strukturën e nxënësve në baza etnike, gjuha e mësimdhënies në shkollë, a mësojnë në shkollë edhe nxënës me nevoja të veçanta, numri i mësimdhënësve, struktura e mësimdhënësve në baza etnike, sfidat kryesore infrastrukurore me të cilat përballet shkolla, numri i mësimdhënësve të Informatikës punojnë në shkollë, përgatitja e tyre profesionale, numri i kabineteve të TIK-ut në shkollë, nga kush janë pajisur kabinetet me pajisje të TIK-ut, numri i përgjithshëm i kompjuterëve në shkollën, numri i kompjuterëve në gjendje të rregullt, mënyra se si furnizohen me materiale shpenzuese për nevoja të TIK-ut (letër, toner për printerë, pjesë të tjera shpenzuese.

4.3. Konkluzionet e pyetësorëve dhe udhëzuesit të intervistave

Pyetësorët u përpiluan prej tre elementëve të shkollës: drejtorit, mësuesve, dhe nxënësve. Mendoj se pyetësorët janë të përpiluar drejt pasi që të dhënat e nxjerra kanë ndihmuar për rezultatet e këtij hulumtimi në punim. U vërejtën disa raste të hezitimeve të vogla të cilat u shoqëruan me ndonjë pyetje të lënë pa përgjigje por kjo ndikonte shumë pak në hulumtim pothuajse e papërfillshme.

Nga përgjigjet që morëm prej pyetësorit rezultoi se kushtet e punës në shkollë janë normale dhe sigurisht ka vullnet për futjen e TIK në mësimdhënie dhe synohet për të bërë përmirësim të vazhdueshëm për integrimin e TIK –ut në procesin mësimor. Komunikimi drejtor- arsimtar është i mirë. Drejtori bën motivimin e brendshëm të punës për secilin arsimtar dhe e motivon rregullisht me lavdërime për punën e mirë që kryen, mbështetje në punën e tyre si dhe duke i ndihmuar për përmirësim të vazhdueshëm në mësimdhënie. Niveli i të kuptuarit dhe bashkëpunimi si nga ana e kolegeve dhe nxënësve ishte tepër optimal.


KAPITULLI V

5. REZULTATET E HULUMTIMIT

5.1. Të dhëna demografike

a) Gjinia


Sa i përket gjinisë së të anketuarve, 22% i takojnë gjinisë femërore ndërsa 78% i takojnë gjinisë mashkullore. Pra rezultatet tregojnë se pjesa dërmuese e mësimdhënësve i takon gjinisë mashkullore.



Grafikoni nr. 1. Gjinia e të anketuarve

b) Moshë

Mësimdhënësit e anketuar i takojnë moshave të ndryshme. Me moshë të re 20 - 29 vjet nuk ka asnjë mësimdhënëës. Pra, asnjë mësimdhënëës nuk është nën moshën 30 vjeçare. 15% e mësimdhënëësve i takojnë moshës 30 - 35 vjet, 47% i takojnë moshës 36 - 45 vjet, 27% i takojnë moshës 45 - 55 vjet. Ndërsa 56 - 65 vjet kemi 11% të të anketuarve.




Grafikoni nr. 2. Moshë e të anketuarve

5.2. Të dhëna rreth aplikimit të TIK-ut në sistemin e mësimdhënies dhe burimeve njerëzore

a) Infrastruktura e shkollës


Nga mësimdhënësit kemi marrë opinione të ndryshme lidhur me gjendjen ifrastrukturës së shkollës. 15% e të anketuarve mendojnë se shkolla ka infrastrukturë të dobët (shkollë e vjetër, nuk i plotëson nevojat), 76% e të anketuarve mendojnë se infrastruktura e shkollës është mesatare, ndërsa 9% e vlerësojnë infrastrukturën e shkollës mbi mesatare.



Grafikoni nr. 3. Infrastruktura e shkollës

b) Plani (TIK) për zhvillimin e shkollës


Në pyetjen tonë se a posedon shkolla plan (TIK) për zhvillimin e shkollës, 87% e të anketuarve janë deklaruar se shkolla posedon një plan të tillë, 0% janë deklaruar se shkolla nuk posedon ndonjë plan të tillë, ndërsa 13% e të anketuarve nuk janë në dijeni për këtë.



Grafikoni nr. 4. Plani (TIK) për zhvillimin e shkollës

c) Prioriteti i TIK-ut në planin zhvillimor

Pyetja e radhës e cila kishte të bëjë me nivelin e pritoritetit që është identifikuar TIK-u në planin zhvillimor, jep këto rezultate: 82% e të anketuarve kanë deklaruar se TIK-ut i është dhënë prioritet i lartë në planin zhvillimor, 16% e të anketuarve se TIK-ut i është dhënë prioritet mesatar, ndërsa 2% e të anketuarve mendojnë se TIK-ut i është dhënë prioritet i ulët në planin zhvillimor.




Grafikoni nr. 5. Prioriteti i TIK-ut në planin zhvillimor

d) Përdorimi i pajisjeve të TIK-ut në shkollë

Në pyetjen se për çfarë qëllimesh shfrytëzohen pajisjet e TIK-ut në shkollën tuaj, kemi këto të dhëna: 62% e të anketuarve mendojnë se pajisjet e TIK-ut përdoren nga mësimdhënësit e informatikës për ligjërime të kësaj lënde, ndërsa 38 % deklarojnë se administrata dhe menaxhmenti i shkollës i përdorin pajisjet për nevojat e shkollës (vërtetime, testet nga arsimtarët dhe për komunikim elektronik (email) me drejtorinë arsimore dhe MASHT-in).


Sa i përket qëllimeve të tjera, me rezultate 0 % kemi këto qëllime: Nga mësimdhënësit për përgatitjen e orëve mësimore, nga mësimdhënësit për ligjërime të lëndëve të tyre, nga nxënësit për të mësuar dhe gjetur informata të reja në lëndë të ndryshme, nga nxënësit për të mësuar dhe gjetur informata të reja në lëndën e Informatikës, nga nxënësit për aktivitete jashtë planprogrameve mësimore, si dhe ne nuk shfrytëzojmë pajisjet e TIK-ut për asnjë qëllim të përmendur më lartë.



Grafikoni nr. 6. Qëllimi i shfrytëzimit të pajisjeve të TIK-ut në shkollë

e) Trajnimi ECDL


Sa i përket qëndrimit: Mundësia e ofruar për të gjithë mësime të mësimdhënësve që të trajnohen përmes vetëm një programi, atij ECDL, kemi këto rezultate: 62% e të anketuarve mendojnë se ky trajnim ka qenë i qëlluar, 27 % e të anketuarve mendojnë se ka qenë e gabuar sepse jo të gjithë kanë qenë në të njëjtin nivel të shkathtësive të TIK-ut, 9% e të anketuarve kanë deklaruar se ka qenë e gabuar sepse shumë prej mësime të mësimdhënësve tashmë kanë poseduar njohuritë bazike në TIK, ndërsa 2% e të anketuarve kanë deklaruar se ka qenë e gabuar sepse është dashur të ofrohet një llojllojshmëri e trajnimeve, ku secili mësime të mësimdhënës do të mund të gjente trajnimin adekuat për të.



Grafikoni nr. 7. Mendimet lidhur me trajnimin e ECDL-së

f) Domosdoshmëria për shkathtësitë e aplikimit të TIK-ut


Një ndër pyetjet e parashtruara në pyetësor ishte edhe pyetja: Si e vlerësoni domosdoshmërinë për shkathtësitë e aplikimit të TIK-ut për mësimdhënësit dhe burimet tjera njerëzore në shkollë?. Në këtë pyetje kemi marrë këto përgjigje: 9% e të anketuarve mendojnë se nuk kërkohen njohuri teknike, 9% kanë deklaruar se mësimdhënësit dhe punonjësit e tjerë kanë njohur themelore në aplikimin e TIK-ut, por kjo nuk është e nevojshme, 62% e të anketuarve mendojnë se aftësitë e TIK-ut janë përparësi konkurruese dhe gjenerojnë mundësi punësimi për të gjithë, ndërsa 20% e të anketuarve mendojnë se njohuritë e TIK-ut janë të nevojshme dhe të preferuara për mësimdhënësit dhe burimet tjera njerëzore.



Grafikoni nr. 8. Domosdoshmëria për shkathtësitë e TIK-ut

g) Mungesa e teksteve mësimore për lëndën e Informatikës


Sa i përket pyetjes: A është e paraqitur mungesa e teksteve mësimore për lëndën e Informatikës?, kemi këto rezultate: 7 % e të anketuarve kanë deklaruar se është paraqitur mungesa e teksteve mësimore për lëndën e informatikës, 11% kanë deklaruar se është paraqitur kjo mungesë deri në një masë, ndërsa 82% e të anketuarve vlerësojnë se nuk është paraqitur aspak mungesa e teksteve mësimore për lëndën e Informatikës.



Grafikoni nr. 9. Paraqitja e mungesës së literaturës për TIK

h) Shkëmbimi i përvojave të shkathtësive të TIK-ut

Sa i përket pyetjes: Si e vlerësoni shkëmbimin e përvojave dhe ofrimin e trajnimeve nga vetë stafi i shkollës (mësimdhënësit e Informatikës, apo edhe të tjerë me shkathtësi të TIK-ut) për kolegët e tyre në shkollën tuaj, kemi këto përgjigje: 7 % e të anketuarve mendojnë se një mundësi e tillë nuk shfrytëzohet fare, 93% e të anketuarve mendojnë se deri më tash kemi vetëm shkëmbim individual të përvojave por jo trajnime të udhëhequra nga stafi i shkollës për kolegët nga kolektivi i shkollës, ndërsa me 0% janë dy optionet e fundit: Kemi përvojë në mbajtjen e këtyre llojeve të trajnimeve, por vetëm me sukses të kufizuar dhe një formë e tillë është shumë e shpeshtë dhe e preferuar në shkollën tonë, për të fituar shkathtësi të reja rreth TIK-ut.




Grafikoni nr. 10. Shkëmbimi i përvojave të TIK-ut

5.3. Informata për qasjen në Internet dhe shfrytëzim të tij

a) Përdorimi i internetit nga nxënësit në shkollë


Lidhur me pyetjen se sa shpesh e përdorin nxënësit e shkollës suaj internetin, kemi këto rezultate: 87% e të anketuarve vlerësojnë se e përdorin kurrë apo shumë rrallë, 13% e të anketuarve konsiderojnë se është përdorim i kufizuar (nxënësit e përdorin Internetin por vetëm nganjëherë dhe jo në baza ditore), ndërsa me 0% të rezultateve kemi dy kategoritë e fundit: përdorim i mirë (nxënësit e përdorin Internetin rregullisht) si dhe përdorim i shkëlqyeshëm (nxënësit e përdorin Internetin për punë, blerje, mësim, argëtim etj).



Grafikoni nr. 11. Përdorimi i internetit nga nxënësit në shkollë

b) Kyçja e nxënësve në internet

Se nga kyçen nxënësit në internet, mësimdhënësit kanë këto mendime: 82% e mësimdhënësve konsiderojnë se nxënësit kyçen në internet nga shtëpia (me 3G), 0 % e të anketuarve vlerësojnë se nxënësit kyçen nga shkolla, çfarë nënkupton se asnjë nxënës nuk e përdorë internetin në shkollë, 11% e mësimdhënësve konsiderojnë se nxënësit kyçen në internet nga vendet publike (p.sh. Internet kafet, bibliotekat komunale, etj.).



Grafikoni nr. 12. Kyçja e nxënësve në internet

5.4. Gjetjet cilësore të studimit

Përveç të dhënave sasiore nga anketat ne kemi mbledhur edhe të dhëna cilësore nga intervista e realizuar me drejtorin e Gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec. Në vijim do të paraqesim të dhënat e nxjerra nga intervista.

Numri i përgjithshëm i nxënësve në këtë shkollë është 950. Shkolla është një etnike ku mësojnë vetëm nxënësit shqiptarë. Kjo nënkupton se gjuha e mësimdhënies në shkollë është gjuha shqipe. Në këtë shkollë nuk ka asnjë nxënës me nevoja të veçanta.

Sa i përket numrit të mësimdhënësve, numri i përgjithshëm i tyre është 45, të cilët janë shqiptarë. Shkolla është e organizuar në dy ndërrime. Në Gjimnazin “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, janë të angazhuar tre mësimdhënës të informatikës. Sa i përket përgatitjes profesionale, një është me Baçelor (Fakulteti i Informatikës), një është baçelor i Elektroteknikës, dhe i treti është master i Makinerisë.

Në këtë shkollë nuk bëhet aplikimi i TIK-ut për shkak të mungesës së kabineteve. Shkolla posedon vetëm një kabinet të TIK-ut, i cili është pajisur me pajisje të TIK-ut nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Shkolla posedon 32 kompjuterë, prej të cilëve punojnë vetëm 28. Sa i përket pakos Office, shkolla përdorë Office 2003. Në kompjuterët e shkollës është instaluar sistemi operativ Windows XP. Lloji i procesorit në kompjuterët e kësaj shkollë është Pentium IV.

Shkolla furnizohet me materiale shpenzuese për nevoja të TIK-ut (letër, toner për printerë, pjesë të tjera shpenzuese) nga DKA. Shkolla nuk ka qasje në internet. Vetëm administrata posedon qasje pa tela (wireless). Shpejtësia e shkarkimit në Internet është në mes 512 Kbps deri 1 Mbps.

5.5. Analiza e korrelacionit

Në këtë hulumtim është bërë edhe analiza e korrelacionit ku janë gjetur disa ndërlidhje (cross - relation) ndërmjet variablave.

Në rezultatet e dala është gjetur korrelacion sinjifikant i variablave në mes të moshës së mësimdhënësve dhe deklarimit që kanë njohuri për TIK-un, që tregon se sa më të rinj që janë mësimdhënësit, aq më shumë kanë njohuri për TIK-un.

Po ashtu të dhënat e hulumtimit tonë tregojnë se mësimitdhënësit që i përkasin gjinisë mashkullore kanë më shumë njohuri për TIK-un se sa mësimitdhënësit e gjinisë femërore, që nënkupton se TIK-u është më atraktiv tek meshkujt se sa tek femrat (flasim vetëm për Rahovecin).

Rezultatet e dala nga hulumtimi tregojnë për një korrelacion sinjifikant në mes të pamjaftueshmërisë së kompjuterëve dhe internetit dhe ndikimit të tij në sfidat e integritit të TIK-ut në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie, që tregon se sa më shumë që i mungojnë kushtet elementare shkollës (sidomos pajisjet teknologjike), aq ma shumë rriten sfidat e integritit të TIK-ut në mësimitdhënie dhe mësimitnxënie.

KAPITULLI VI

6. DISKUTIME

6.1. Diskutime lidhur me gjetjet empirike të studimit

Të dhënat e dala nga hulumtimin pasqyrojnë deklaratimet e mësimeve dhe drejtorin e Gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec lidhur me sfidat e integritit të TIK-ut në mësime dhe mësime. Kemi anketuar 45 mësime, 22% prej tyre i kanë takuar gjinisë femërore ndërsa 78% i kanë takuar gjinisë mashkullore. Në anketat e bëra, është konstatuar se gjinia mashkullore është më shumë e informuar lidhur me TIK-un dhe rëndësinë e saj në procesin e mësimeve dhe mësimeve.

Nga hulumtimi i realizuar kjo shkollë nuk ka asnjë mësime nën moshën 30 vjeçare, ndërsa 11% prej tyre i takojnë moshës 56 -65 vjet. Sa i përket moshës, është konstatuar se mësimeve të cilët i takojnë moshës më të re, janë më të përgatitur dhe të informuar lidhur me integritin e TIK-ut në mësime dhe mësime.

Mësimeve kryesisht pajtohen se infrastruktura e shkollës është mesatare. Mësimeve kanë pohuar se shkolla posedon plan (TIK) për zhvillimin e shkollës (87%). Një përqindje, thuajse e përafërt, (82%) arrihet edhe me deklaratimet se TIK-ut i është dhënë prioritet i lartë në planin zhvillimor.

Gjatë analizës së të dhënave kemi konstatuar se pajisjet e TIK-ut përdoren nga mësimeve e informatikës për ligjërime të kësaj lënde, ndërsa deri diku edhe nga administrata dhe menaxhmenti i shkollës.

Është i paevitueshëm fakti se pajisjet e TIK-ut nuk përdoren nga mësimeve për përgatitjen e orëve mësimore dhe për ligjërime të lëndëve të tyre, nuk përdoren nga nxënësit për të mësuar dhe gjetur informata të reja në lëndë të ndryshme, apo për të gjetur informata të reja në lëndën e Informatikës. Pajisjet nuk përdoren nga nxënësit as për aktivitete jashtë plan programeve mësimore.

Sa i përket trajnimit ECDL për mësimeve, mendohet se ky trajnim ka qenë i qëlluar, por ka edhe të tjerë që mendojnë se ky trajnim ka qenë i gabuar sepse jo të gjithë kanë qenë në të njëjtin nivel të shkathtësive të TIK-ut.

Gjatë mbledhjes së të dhënave dhe analizës së tyre kemi arritur informacione se mësimdhënësit pajtohen në masë të madhe se aftësitë e TIK-ut janë përparësi konkurruese dhe gjenerojnë mundësi punësimi për të gjithë, madje këto njohuri janë të nevojshme dhe të preferuara për mësimdhënësit dhe burimet tjera njerëzore.

Mësimdhënësit konstatojnë se në shkollën e tyre ka mjaft tekste mësimore për lëndën e Informatikës. Ata po ashtu mendojnë se deri më tash kanë pasur vetëm shkëmbim individual të përvojave por jo trajnime të udhëhequra nga stafi i shkollës për kolegët nga kolektivi i shkollës.

Sa i përket inventarit përcjellës të kabineteve të informatikës, pjesa dërmuesve kanë zgjedhur opsionin se inventari përcjellës është mesatarisht i përshtatshëm ndërsa të njëjtit poashtu kanë vlerësuar se si instalimi elektrik në kabinetet e informatikës është jashtëzakonisht i përshtatshëm.

Është për t'u habitur fakti se është gjetur e dhëna se në shkollë interneti shfrytëzohet për shërbimet administrative dhe menaxhment të shkollës. Kjo nënkupton se interneti në shkollë nuk përdoret për qasje në Informacion nga mësimdhënësit me qëllim të përgatitjes së orës mësimore; nuk përdoret për qasje në Informacion nga nxënësit me synime arsimore dhe hulumtim shkencor; nuk përdoret për qasje në Informacion nga mësimdhënësit dhe nxënësit për qëllime argëtuese (si Fb, twitter etj); por për komunikim elektronik (email, detyra nga lënda TIK). Gjatë hulumtimit tonë është konstatuar se nxënësit nuk e përdorin internetin e shkollës kurrë ose shumë rrallë dhe ata kryesisht kërcejnë në internet nga shtëpia (me 3G).

Sa i përket gjetjeve cilësore, kemi konstatuar se shkolla me 950 nxënës posedon vetëm tre mësimdhënës të TIK-ut, ku vetëm njëri prej tyre ka përgatitje Bachelor të drejtimit përkatës, gjëgjësisht të Fakultetit të Informatikës. Po ashtu është konstatuar se shkolla ka vetëm një kabinet të TIK-ut, dhe kjo nuk ndikon në zhvillimin e mëtutjeshëm të TIK-ut për mësimdhënie dhe mësimnxënie.

6.2. Krahasim i rezultateve të punimit me rezultatet e hulumtimit me shkollë tjetër

Në hulumtimin tonë kemi bërë krahasim me një ndër shkollat më të dalluara të kryeqytetit, pra me gjimnazin "Sami Frashëri" në Prishtinë. Sa i përket numrit të nxënësve, krahasuar me gjimnazin "Xhelal Hajda – Toni" në Rahovec, gjimnazi "Sami

Frashëri” në Prishtinë ka gjithsej 1098 nxënës, që do të thotë se ka 148 nxënës më shumë se gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec. Një numër të përafërt këto shkolla kanë edhe me numrin e mësimdhënësve. Përderisa gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec ka 45 mësimdhënës, gjimnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë ka 48 mësimdhënës, që do të thotë 3 mësimdhënës më shumë.

Edhe pse gjimnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë, ka një numër më të madh të nxënësve, (148 nxënës më shumë), numri i mësimdhënësve të TIK-ut është i njëjtë Pra, kjo shkollë ka tre mësimdhënës të TIK-ut, njësoj si gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec.

Nëse bëjmë krahasim lidhur me përgatitjen shkollore të mësimdhënësve të TIK-ut në këto dy shkolla, atëherë gjejmë se në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë, përgatitja shkollore e mësimdhënësve të TIK-ut është si vijon: një inxhinier i matematikës, një inxhinier i elektroteknikes si dhe një Baçelor i shkencave kompjuterike.

Ndërsa në gjimnazin “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, një mësimdhënës është me përgatitje adekuate, pra baçelor i informatikës, ndërsa dy të tjerët kanë këtë përgatitje shkollore: inxhinier i elektros dhe master i makinerisë.

Përderisa gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” posedon 32 kompjuterë (Pentium 4), 28 prej të cilëve janë në gjendje të rregullt, ndërsa 4 janë jashtë funksionit, gjimnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë, posedon 45 kompjuterë, të cilët janë në gjendje të rregullt, si dhe 9 laptopë, gjë që gjimnazi “Xhelal Hajda - Toni” në Rahovec nuk ka asnjë laptop.

Përderisa gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec përdor Office 2003, ka të instaluar sistemi operativ Windows XP, ndërsa lloji i procesorit në kompjuterët e kësaj shkollë është Pentium IV, gjimnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë, përdorë sistem më të avancuar. Ajo përdor Office 2010, ka të instaluar sistemin operativ Windows 7, ndërsa lloji i procesorit është Intel Celeron E 3400 @ 2.60GHz 2.60 GHz.

Në këtë aspekt shihet se kjo shkollë në Prishtinë edhe pse me kapacitet thuajse të njëjtë të nxënësve, është më e avancuar. Përderisa gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec ka vetëm një kabinet të TIK-ut, gjimnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë posedon 3 kabinate të tilla.

Si në gjimnazin “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec që nuk ka kabinetin qasje në internet, e njëjta gjë ndodh edhe me gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë, kabinetet e të cilit nuk kanë qasje në internet, por kanë vetëm zyra e drejtorit, zëvendës-drejtorit, sekretarja dhe salla e arsimtarëve.

Sa i përket shpejtësisë së shkarkimit të internetit, në gjimnazin “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec është 512 Kbps deri 1 Mbps, shpejtësia e shkarkimit të Internetit në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë është 4.33 Mbps, e që është një dallim shumë i madh.

Një gjë që duhet potencuar është se as nxënësit e gjimnazit “Sami Frashëri” nuk e përdorin internetin në shkollë, sikurse nxënësit e gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec. Shkolla në Rahovec nuk përdorë ndonjë platformë online falas ndërsa gjimnazi “Sami Frashëri” përdor platformën falas Bit Media.

6.3. Analizë krahasuese

Edhe pse janë dy shkolla me numër të përafërt nxënësish, me numër të përafërt mësimdhënësish dhe me numër të njëjtë të mësimdhënësve të TIK-ut, konsiderohet se në gjimnazin “Sami Frashëri” në Prishtinë, TIK-u është më i integruar në mësimdhënie dhe mësimnxënie.

Arsyeja qëndron në faktin gjimnazi “Sami Frashëri” ka më shumë kompjuterë se sa gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, pastaj të gjithë kompjuterët janë në gjendje të rregullt. Arsye tjetër pse kjo shkollë është më e suksesshme është se DKA në Prishtinë e përkrahë më shumë duke ia mundur kyçjen me internet në kabinetin e TIK-ut kurse gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec nuk ka qasje në internet në kabinet. Një arsye tjetër qëndron sepse gjimnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë ka 3 kabinate të TIK-ut, ndërsa gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec, ka vetëm një kabinet.

Nga e tëra kjo mund të konkludohet se sfidat e gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec nuk janë sfida të mësimdhënësve por sfida në nivel shkolle. Sfidat në nivelin e mësimdhënësve i referohen mungesës së besimit, mungesës së kohës dhe rezistencës ndaj ndryshimit, ndërsa sfidat në nivel shkolle i referohen mungesës së trajnimeve efektive në zgjidhjen e problemeve teknike dhe mungesën e qasjes në burime.

6.4. Testimi i hipotezave

Hipotezat e parashtruara në këtë studim ishin katër, të cilat i testuam duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës por edhe në rezultatevet e nxjerra nga të dhënat sasiore (anketat) të cilat i kemi realizuar.

H1. Motivimi i arsimtarëve për shfrytëzimin e TIK-ut është një katalizator i rëndësishëm për ngritjen e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Kjo hipotezë është verifikuar plotësisht pasi që gjatë realizimit të anketave dhe intervistave që i kemi realizuar me mësimdhënës të TIK-ut dhe mësimdhënës të lëndëve të përqjithsme, ata kanë shprehur gatishmërinë për të avancuar metodat e tyre të mësimdhënies nëse do të motivoheshin në forma të ndryshme për shfrytëzimin e TIK-ut (p.sh. sigurimi i laptovëve për të gjithë mësimdhënësit, qasja në internet nga shkolla për të gjithë mësimdhënësit pasi që e kanë të kufizuar këtë qasje, etj.)

H2. Stafi mësimor nuk është i përgatitur në nivel të duhur për shfrytëzimin e TIK-ut.

Kjo hipotezë është relative, pra e verifikuar pjesërisht, pasi që ekzistojnë dallime të mëdha në përgatitjen dhe shkathhtësitë e mësimdhënësve për përdorimin e TIK-ut.

H3. Shfrytëzimi i TIK-ut varet kryesisht nga infrastruktura teknologjike që e posedon shkolla.

Kjo hipotezë është verifikuar plotësisht pasi që nga mbledhja e të dhënave kemi konstatuar se në rast se mungon infrastruktura teknologjike, atëherë paraqiten mangësi dhe pengesa të shumta në shfrytëzimin e TIK-ut.

H4. Zbatimi i suksesshëm i TIK –ut varet nga mundësia për qasje në internet në shkollë.

Edhe kjo hipotezë është verifikuar pasi që nga hulumtimet e bëra me burime parësore (anketa dhe intervista) si dhe burime dytësore (shqyrtimi i literaturës) kemi konstatuar se në rast se qasja në internet është e dobët apo mungon herë pas here, atëherë edhe zbatimi i TIK-ut nuk do të ketë sukses.

6.5. Validiteti i studimit

Që nga fillimi i procesit të punës për realizimin e këtij studimi, jemi përpjekur për t'iu përmbajtur rregullores së fakultetit për punimin e temës së magjistraturës, por edhe parimeve etike që kanë të bëjnë me procesin e anketimit dhe intervistimit, por edhe citimin e literaturës së përdorur. Nga kjo konsiderojmë se studimi ynë është origjinal dhe ka vlerë shkencore pasi që trajtohet një temë që sot është e ndjeshme për arsimin në Kosovë.

7. KONKLuzionet

TIK-u nuk është vetëm një mjet për të prezantuar përmbajtjet ekzistuese përmes mjediseve të reja, por ai është gjithashtu një mjet për paraqitjen e modeleve të reja të të nxënësve.

Në shkollat tona nuk ekziston mënyra e organizuar e mësimin përmes përdorimit të kompjuterit nga nxënësit dhe mësuesit, në mënyrë që nxënësve t'u mundësohet qasje më e lehtë për përdorimin e kompjuterit për qëllime arsimore. Sipas vëzhgimeve që kam bërë në shkollën ku edhe jap këtë lëndë, kam konstatuar se shkolla ka kompjuterë mirëpo nuk është e rëndësishme vetëm prania e kompjuterëve në shkolla, por kërkohet aftësi pedagogjike për përdorimin e tyre si për mësuesin, ashtu edhe për nxënësin.

Mësuesit janë trajnuar për programin ECDL, mirëpo gjatë një hulumtimi paraprak nga drejtori e shkollës, konsiderohet se mësuesit nuk janë të kënaqur me këtë program. Ata kanë kërkuar programe që kanë të bëjnë me atraktivitetin e jo me ato programe, të cilat sipas opinionëve të mësuesve ishin shumë të vështira për t'u mësuar.

Mungesa e udhëzimeve të mësuesve për integrimin e TIK-ut në mësim është mjaft e dukshme, këtë e vërejt gjatë punës sime si mësues i TIK-ut. Nxënësit vetëm një herë në javë shkojnë në kabinetin e TIK-ut, por edhe kompjuterët në atë kabinet nuk janë të lidhur me internetin. Gjithashtu është e dukshme fakti se mësuesit në shkollë nuk i ofrojnë njohuri nxënësve për përdorimin e TIK-ut për nevojat pedagogjike, për shkak se të mësuesit mungonte përqendrimi për strategjitë e mësimin edhe përmes TIK-ut.

8. REKOMANDIMET

Bazuar në hulumtimet e bëra, me qëllim të tejkalimit të sfidave të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie, sugjerojmë këto rekomandime, të cilat i drejtohen drejtorisë dhe drejtorit të gjimnazit “Xhelal Hajda – Toni” në Rahovec:

- Të iniciojë procedurat e krijimit për krijimin e një infrastrukture moderne dhe të përshtatshme për mësimdhënie moderne dhe efektive;
- Të gjejë përkrahje financiare për pajisjen e shkollës me infrastrukturë funksionale për shfrytëzimin e informacionit (kompjuter, laptopë, tabletave smart);
- Të kërkojë nga DKA përkrahje që të sigurojë Internet me shpejtësi të lartë dhe mundësi qasjeje online edhe në mjedise të tjera brenda shkollës, jo vetëm në kabinetin e TIK-ut;
- Të krijojë mekanizma për të siguruar përkrahje teknike që do të siguronte efikasitet në përdorimin e infrastrukturës së TIK-ut.

9. BIBLIOGRAFIA

1. Abdullah, B. K. (2008). Barriers to the successful integration of ICT in teaching and learning environments. Në B. K. Abdullah, Barriers to the successful integration of ICT in teaching and learning environments (fv. 235-243). Bandoora, Australia: RMIT university.
2. Academy for Educational Development ADE . (2013). Integrating Educational Technology into the Curriculum.
3. Al-Alwani, A. (2005). Barriers to information technology in Saudi Arabia Science Education. The University of Kansas, Kansas.
4. Anchor Court, K. R. (2013). The impact of ICT on pupils' learning in primary schools. Estyn.
5. Balanskat, A., et al (2006). A review of studies of ICT input on schools in Europe. European Schoolnet.
6. Bekteshi, Luan (2016). Sfidat dhe Avantazhet e Përdorimit Të ICT në Universitet: Rasti i Universitetit të Elbasanit. Tiranë: UET.
7. Billowes, N. (2001). ICT activities that make a difference. Wellington: Ministry of Education.
8. British Educational Communications and Technology Agency (Becta), (2004). A review of the research literature on barriers to the uptake of ICT by teachers. <http://www.becta.org.uk>
9. Burbles, N. C., Callister, T. A. (2000). "Watch IT: The risks and promises of information technologies for education", Boulder, Co: WestviewPress.
10. C.Paul, D. (2013). Literature Review the IMPACT of ICT on learning and Teaching.
11. Caka, Nebi (2004). Zhvillimi i burimeve njerëzore në Kosovë në lëmin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimeve (TIK), Prishtinë.
12. Chappelle, C. (2001). Computer applications in second language acquisition: Foundations for teaching, testing and research (Vol.XVII). Cambridge: Cambridge University Press.

13. Charalambos Vrasidas, I. P. (2010). Teacher Use of ICT: Challenges and Opportunities. International Conference on networked learning. University of Nicosia.
14. Christensen, R. (2002). Effects of Technology Integration Education on the Attitudes of Teachers and Students. *Journal of Research on Technology in Education* , 411-433.
15. Christina Preston, M. D. (2005). ECDL for Educators. ECDL for educators.
16. Cisco. (2013). Education and the Internet of Everything.
17. Crawford, R. (1997). "Managing Information Technology in Secondary Schools", Routledge, London.
18. Çoçaj, N. (2014). KËRKIME PEDAGOGJIKE (Përmbledhje punimesh). Prishtinë.
19. Dalipi, F. (2013). Teknologjia Informative Komunikuese ne arsim. Shkup: Fakulteti Pedagogjik.
20. Debevc, M., Povalej, P., Verlič, M., & Stjepanovič, Z. (2007). Exploring Usability and Accessibility of an E-Learning System for Improving. Tunisia: ICTA-University of Maribor, Faculty of Electrical Engineering and Computer Science.
21. Dellit, M. J. Using ICT for Quality in Teaching- Learning Evaluation Processes. South Australia 2010.
22. Developet by central institut of educational Teknology. (August, 2013.). Information and communication Technoligy for the school System Curricula for ICT in Education. New Delhi.
23. Dudeney, G. (2000). The internet and the language classroom (Vol.X). Cambridge: Cambridge University Press.
24. Duderstat, J. J. (1999). Can Colleges and Universities Survive in the Information Age?, Information Technology and the New Competition in Higher Education. San Francisco: Jossey-BassPublishers.
25. Ertmer, P. (1999). Addressing first- and second-order barriers to change: Strategies for technology integration. *Educational Technology Research and Development*, vol. 47, nr. 4, 47-61.
26. Eurpean/Commission. (2002). Survey of Schools: ICT in Education. Eurpean Commission.
27. Ezza, E.-S. Y. (2012). EFL Teacher's Role in ICT-oriented Classroom. 1-24.
28. Fazliu, Agron (2013). Depërtimi dhe përdorimi i internetit në Kosovë. Prishtinë: STIKK.

29. Gaible, E. (2011). Using Technonogy to train teachers. Appropriate use of ICT for teacher.
30. Garret, N. (1991). Technology in the service of language learning: Trends and issues. *Modern Language Journal*, vol. 75, nr. 1, 74-101.
31. Hargreaves, A. (2003). *Teaching In the Knowledge Society: Education in the Age of Insecurity*. Teachers' College Press and Buchingam Open University Press, New York.
32. Harkrishan, S. G., & Jagadhri. (2012). ICT AND TEACHER EDUCATION. *Asian Journal of Multidimensional Research* , 198-202.
33. Haxhere, Z., & Selim, M. (2012). Zhvillimi i kompetencave për Tik dhe gjuhë angleze-perspektivë për integrim në epokën digjitale. Prishtinë.
34. Haydn/Terry. (2012). *Teacher education and ICT*. University of East Anglia , 1-4.
35. InfoDEV. (2010). *ICT in School Education (Primary and Secondary)*.
36. Jane Itohan Oviawe, L. E. (2011). *Impact of Information and Communication Technology on Teaching and Learning Ability of Education Students*. *International Review of Social Sciences and Humanities* , 127-133.
37. Johnson, L. (2012). *The Effect of desing teams on preservice tachers technology*.
38. Jones, A. (2004). *A review of the literature on barriers to the uptake of ICTs by teachers*. (Research report). London: British Educational Communications and Technology Agency.
39. Kalas, I., Bannayan, H. E., Conery, L., Laval, E., Laurillard, D., Lim, C. P., etj. (2012). *ICT in Primary Education*. Moskow: Unesco.
40. Kenesson, R. C. (January 2007). *The impact of ICT in schools* . Quality in Education Centre, University of Strathclyde *The impact of ICT in schools – a landscape* .
41. L.Tinio, V. (2002-2003). *ICT in education*. New York, NY 10017.
42. Lim, C. P., Zhao, Y., Tondeur, J., Chai, S. C., & Tsai, C. C. (2013). *Technology Trends and Use of Technology in Schools*. *Educational Technology & Society* , 59-68.
43. Maholwana-Sotashe, N. L. (2007). *Challenges faced by secondary school teachers in integrating ICT into the curriculum*. Rhodes University.
44. MASHT (2011) *Draft Strategjia për Mësimin Elektronik*. (Dokument intern)
45. MASHT (2015). *Konkursi i regjistrimit të nxënësve në SHML 2015/2016*.

46. MASHT (2016). PLANI STRATEGJIK I ARSIMIT NË KOSOVË 2017-2021. E mundshme në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf. (Qasja e fundit: 4 qershor, 2017).
47. MASHT. (2016). Plani Strategjik i Arsimit ne Kosove 2017-2021. Prishtine, Kosova.
48. Matthews, B. Ross, L. (2010). Metododat e hulumtimit - Udhëzues praktik për shkencat sociale dhe humane. CDE, 167.
49. Maxhuni, A. (2014). Integrimi i teknologjise informative te komnikimit ne mesimdhenje dhe nxenie. Prishtine: Instituti Pedagogjik i Kosoves.
50. Means, B., et al. (1993). Using technology to support education reform. <http://www.ed.gov/pubs/EdReformStudies/TechReforms/>
51. Mentor, H., Blerim, R., & Andrea, B. (2013). Ethical Use of Information Technology in High Education. Tetova, Macedonia, Macedonia.
52. Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit (2006). Strategjia Nacionale për Shoqëri të Informacionit 2006-2012. E mundshme në: [http://www.mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia Nacionale per Shoqeri te Informacionit 2006-2012.pdf](http://www.mzhe-ks.net/repository/docs/Strategjia_Nacionale_per_Shoqeri_te_Informacionit_2006-2012.pdf). (Qasja e fundit: 3 qershor, 2017).
53. Ministria e Zhvillimit Ekonomik (2013). Politikat e Sektorit të Komunikimeve Elektronike – Axhenda Dixhitale për Kosovën 2013 – 2020. Prishtinë.
54. Moonen, J. and Kommers, P. (1995). Implementation of Communication and Information Technologies in Education. Report to the Advice Committee for Educational Research, Dutch Organization for Scientific Research, Den Haag, The Netherlands.
55. Noor-Ul-Amin, S. (a.d.). An Effective use of ICT for education and learning by drawing on worldwide knowledge, research an experience. Kashmir, Kashmir, Kashmir.
56. Oviawe, J. I., & Oshio, L. E. (2011). Impact of Information and Communication Technology on Teaching and Learning Ability of Education Students. International Review of Social Sciences and Humanities , 127-133.
57. Pelgrum, W. J. (2001). Obstacles to the integration of ICT in education: Results from a worldwide educational assessment. Computers and Education, vol. 37, 163-178.
58. Rajbenbach, H. (2013). Smart Systems Integration in the UCT programme .
59. Roblyer, M.D. (2000). Integrating educational technology into teaching. Upper Saddle River, New Jersey: Prentice Hall.

60. S. Kennewell, H. T. (2007). Analysing the use of interactive technology to implement interactive teaching. *Journal of Computer Assisted Learning* , 61-73.
61. Salihu, A. (2012, Tetor). MATERIAL DISKUTIMI PËR TË ARRITURAT, SFIDAT DHE REKOMANDIMET NË FUSHËN E ARSIMIT DHE SHKENCËS NË KOSOVË. Prishtine, Kosove.
62. Sarkar, S. (2012). The Role of Information and Communication technology in Higher Education for the 21st Century. Agartala: ICFAI University Tripura.
63. Schoepp, K. (2005). Barriers to technology integration in a technology-rich environment. *Learning and Teaching in Higher Education: Gulf Perspectives*, vol. 2, nr. 1, 1-24.
64. Smerdon, B, et al. (2000). Teachers' tools for the 21st century. National Center for Educational Statistics. <https://nces.ed.gov/pubs2000/2000102.pdf>
65. Shala- Bajrami, Luljeta (2016). Gjuha urrejtëse e nxënësve në mediet sociale, Prishtinë, Instituti Pedagogjik i Kosovës.
66. Shri Guru Harkrishan, J. S. (2012). ICT AND TEACHER EDUCATION. *Asian Journal of Multidimensional Research* , 198-202.
67. Teacher ICT Skills, Departemnt of Education an Trajning. (2012). Evaluation of the information and Communication Technology ICT. Western Australia.
68. Teemu Valtonen, K. M.-S. (2012). Facing Challenges with New Teachers' Use of ICT in Teaching and Learning. *IEEE Technical Committee on Learning Technology* , 46-49.
69. UNESCO (2003). "Developing and Using Indicators of ICT Use in Education", UNESCO Asia Regional Bureau for Education. E mundshme në: http://www.unescobkk.org/fileadmin/user_upload/ict/e-books/ICTedu/ictedu.pdf. (Qasja e fundit: 3 qershor, 2017).
70. University, R. Does ICT improve and teaching in schools. Newcastle: Newcastle University.
71. Watson, S. L. And Watson, W. R. (2011). The role of Technology and Computer Based Instruction in a Disadvantaged Alternative School's Culture of Learning. *Computers in the Schools*, 28(1).
72. Wishart, J. (1999). Theories underlying perceived changes in teaching and learning after installing a computer networking a secondary school. *Educational Technology*, vol. 30, nr. 1, 25-41.

73. Yahya, E. E.-S. (2012). EFL Teacher's Role in ICT-oriented Classroom. 1-24.
74. Young, S.S.C. (2003). Integrating ICT into second language education in a vocational high school. *Journal of Computers Assisted Learning*, vol.19, 447-461.
75. Yunus, M. M. (2009). Language Learning via ICT: Uses, Challenges and Issues. *WSEAS Transactions on Information Science and Applications*, vol. 6, nr. 9, 1453-1467.
76. Yunus, M.M. (2007). Malaysian ESL teachers' use of ICT in their classrooms: expectations and realities. *RECALL: The Journal of EUROCALL*, vol.9, nr. 1, 79-95.
77. <https://masht.rks.gov.net/uploads/2015/06/a-mexhuani-integrimi-i-tik-ut-ne-mesimdhenie-dhe-nxenie-1.pdf>
78. http://ec.europa.eu/epale/sites/epale/files/udhezuesi-me-situata-te-te-nxenit-me-tikun-burim_izha_2015.pdf
79. Cohen, L. And Others." *Research Methods in Education* ",(2011) London, fq:180-182
80. <https://www.education.ie/en/Publications/Policy-Reports/Digital-Strategy-for-Schools-2015-2020>

10. SHTOJCA 1. PYETËSOR PËR MËSIMDHËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME TË LARTË “XHELAL HAJDA – TONI” – RAHOVEC

Të nderuar mësimdhënës,

Ky pyetësor është një instrument matës i cili është përpiluar me qëllim të realizimit të Temës së Magjistraturës me titull: “Sfidat e integritit të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie” (Rast Studimi: Gjimnazi “Xhelal Hajda – Toni “ në Rahovec). Ju garantoj se të dhënat që do të mblidhen do të jenë anonime dhe do të përdoren vetëm për rastin studimor të cekur më lart, dhe asesi të përdoret për qëllime të tjera.

Ju falënderoj shumë!

A. Të dhëna demografike dhe Informacione rreth aplikimit të TIK-ut në sistemin e mësimdhënies dhe burimeve njerëzore

1. Gjinia	a) Femër b) Mashkull
2. Moshë	a) 20 -29 vjet b) 30 -35 vjet c) 36 -45 vjet d) 46 -55 vjet e) 56 -65 vjet
3. Pasqyrë e përgjithshme e gjendjes së Infrastrukturës TIK-ut në shkollë	c) E dobët d) Mesatare e) Mbi mesatare
4. A posedon shkolla plan (TIK) për zhvillimin e shkollës	a. Po b. Jo c. Jemi në fazën e krijimit
5. Në çfarë niveli të prioriteteve është identifikuar TIK-u në planin zhvillimor	a. Prioritet i lartë b. Prioritet mesatar c. Prioritet i ulët
6. Për çfarë qëllimesh shfrytëzohen pajisjet e	a. Nga mësimdhënësit për përgatitjen e orëve mësimore

<p>TIK-ut në shkollën tuaj</p>	<ul style="list-style-type: none"> b. Nga mësime të mësuara të Informatikës për ligjërime të kësaj lënde c. Nga mësime të mësuara të lëndëve të tyre d. Nga administrata dhe menaxhmenti i shkollës e. Nga nxënësit për të mësuar dhe gjetur informata të reja në lëndë të ndryshme f. Nga nxënësit për të mësuar dhe gjetur informata të reja në lëndën e Informatikës g. Nga nxënësit për aktivitete jashtë planprogrameve mësimore h. Nëse nuk shfrytëzojmë pajisje të TIK-ut për asnjë qëllim të përmendur më lartë
<p>7. Mundësia e ofruar për të gjithë mësime të mësuara që trajnohen përmes vetëm një programi, atij ECDL</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Ka qenë e qëlluar b. Ka qenë e gabuar sepse jo të gjithë kanë qenë në të njëjtin nivel të shkathtësisë të TIK-ut c. Ka qenë e gabuar sepse shumë prej mësime të mësuara tashmë kanë poseduar njohuritë bazike të TIK d. Ka qenë e gabuar sepse është dashur të ofrohet një llojllojshmëri e trajnimeve, ku secili mësime të mësuara do të mund të gjente trajnimin adekuat për të.
<p>8. Si e vlerësoni domosdoshmërinë për shkathtësinë e aplikimit të TIK-ut për mësime të mësuara dhe burimet tjera njerëzore në shkollë</p>	<ul style="list-style-type: none"> a. Nuk kërkohen njohuri teknike b. Mësime të mësuara dhe punonjësit e tjerë kanë njohuri themelore në aplikimin e TIK-ut, por kjo nuk është e nevojshme c. Aftësitë e TIK-ut janë përparësi konkurruese dhe gjenerojnë mundësi punësimi për të gjithë d. Njohuritë e TIK-ut janë të nevojshme dhe të preferuara për mësime të mësuara dhe burimet tjera njerëzore
<p>9. A është e paraqitur mungesa e teksteve</p>	<ul style="list-style-type: none"> 1. Po 2. Deri në një masë

mësimore për lëndën e Informatikës	3. Jo
10. Si e vlerësoni shkëmbimin e përvojave dhe ofrimin e trajnimeve nga vetë stafi i shkollës (mësimdhënësit e Informatikës, apo edhe të tjerë me shkathtësi të TIK-ut) për kolegët e tyre në shkollën tuaj	<ul style="list-style-type: none"> a. Një mundësi e tillë nuk shfrytëzohet fare b. Deri më tash kemi vetëm shkëmbim individual të përvojave por jo trajnime të udhëhequra nga stafi i shkollës për kolegët nga kolektivi i shkollës c. Kemi përvojë në mbajtjen e këtyre llojeve të trajnimeve, por vetëm me sukses të kufizuar. d. Një formë e tillë është shumë e shpeshtë dhe e preferuar në shkollën tonë, për të fituar shkathtësi të reja rreth TIK-ut

B. Informata të përgjithshme për Infrastrukturën e TIK-ut në shkollë

11. Si e vlerësoni inventarin përcjellës të kabineteve tuaja të Informatikës (tavolinat, karriget, tabelat etj)	<ul style="list-style-type: none"> a. Jashtëzakonisht i përshtatshëm b. I përshtatshëm mbi mesataren c. Mesatarisht i përshtatshëm d. I përshtatshëm nën mesataren e. I papërshtatshëm
12. Si e vlerësoni instalimin elektrik të kabineteve tuaja të Informatikës	<ul style="list-style-type: none"> a) Jashtëzakonisht i përshtatshëm b) I përshtatshëm mbi mesataren c) Mesatarisht i përshtatshëm d) I përshtatshëm nën mesataren e) I papërshtatshëm

C. Informata për qasjen në Internet dhe shfrytëzim të tij

13. Në shkollë Interneti shfrytëzohet për:	<ul style="list-style-type: none">a. Shërbimet administrative dhe menaxhment të shkollësb. Qasje në Informacion nga mësimdhënësit me qëllim të përgatitjes së orës mësimorec. Qasje në Informacion nga nxënësit me synime arsimore dhe hulumtim shkencord. Qasje në Informacion nga mësimdhënësit dhe nxënësit për qëllime argëtuesee. Komunikim elektronikf. Nuk shfrytëzohet fare
14. Sa shpesh e përdorin nxënësit e shkollës suaj Internetin	<ul style="list-style-type: none">a. Kurrë apo shumë rrallëb. Përdorim i kufizuar (nxënësit e përdorin Internetin por vetëm nganjëherë dhe jo në baza ditore)c. Përdorim i mirë (nxënësit e përdorin Internetin rregullisht)d. Përdorim i shkëlqyeshëm (nxënësit e përdorin Internetin për punë, blerje, mësim, argëtim etj).
15. Prej nga kyçen në Internet nxënësit	<ul style="list-style-type: none">a. Nga shtëpiab. Nga shkollac. Nga vendet publike (p.sh. internet kafet apo bibliotekat komunale)d. Nuk kyçen në Internet fare

11. SHTOJCA 2. UDHËZUES INTERVISTE

I/ e nderuar,

Ky pyetësor është një instrument matës i cili është përpiluar me qëllim të realizimit të Temës së Magistraturës me titull: “Sfidat e integritetit të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie” (Rast Studimi: Gjumnazi “Xhelal Hajda –Toni “ Në Rahovec). Ju garantoj se të përgjigjet që do t’i marrim do të përdoren vetëm për rastin studimor të cekur më lart, dhe assesit të përdoret për qëllime të tjera.

Ju falënderoj shumë!

Pyetje:

1. Cili është lloji dhe drejtimet e shkollës?
2. Sa është numri i nxënësve në shkollën tuaj?
3. Si është struktura e nxënësve në baza etnike?
4. Cila është gjuha e mësimdhënies në shkollë?
5. A mësojnë në shkollë edhe nxënës me nevoja të veçanta?
6. Cili është numri i mësimdhënësve?
7. Cila është struktura e mësimdhënësve në baza etnike?
8. Në sa ndërrime është organizuar mësimi?
9. Cilat janë sfidat kryesore infrastrukturore me të cilat përballet shkolla?
10. Sa mësimdhënës të Informatikës punojnë në shkollë?
11. Cila është përgatitja e tyre profesionale?
12. A keni punësuar profesionistë të tjerë të TIK-ut për mirëmbajtje apo qëllime tjera për nevoja të shkollës?
13. Sa është numri i kabineteve të TIK-ut në shkollën tuaj?
14. Nga kush janë pajisur kabinetet me pajisje të TIK-ut?
15. Sa është numri i përgjithshëm i kompjuterëve në shkollën tuaj?
16. Sa është numri i kompjuterëve në gjendje të rregullt?
17. Si furnizoheni me materiale shpenzuese për nevoja të TIK-ut (letër, toner për printerë, pjesë të tjera shpenzuese)?

12. SHTOJCA 3. DEKLARATA E LEKTORIT



Telefoni: +386 49 377 438, e-mail adresa: shukrie.rama@gmail.com

Unë, Shukrije Rama, me profesion Lektor, nën përgjegjësi morale dhe materiale, me datë 9 qershor, 2017, jap këtë:

DEKLARATË

Me të cilën deklaroj se kam lekturuar temën e Masterit, me titull "Sfidat e integritetit të TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie" (Rast Studimi: Gjimnazi "Xhelal Hajda - Toni" në Rahovec), të kandidatit Beqir MUSTAFA.

Prishtinë, 09. 06. 2017



LEKTORE

Shukrije RAMA

13. SHTOJCA 4. LEJA NGA DKA - RAHOVEC



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Komuna Rahovec / Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Arsim
Odeljenje za Obrazovanje
Department for Education

	9.06.2017
Referenc-ë	071697
Për/Za/To:	z. Beqir Mustafa
CC:	Për hulumtim-Sfidat e integritit të TIK-ut
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria Komonale të Arsimit - Rahovec
Nga/Od/From:	znj.Vjollca Vuçitërna, Drejtoreshë e DKA-së
Subjekti/Predmet/Subject:	P ë l q i m

Me kërkesën e z. Beqir Mustafa nga Rahoveci, Drejtoria Komonale e Arsimit në Rahovec I miraton kërkesën për hulumtim të temës së lartëcekur në shkollën e mesme "Xhelal Hajda-Toni " në Rahovec

Lutet drejtori I shkollës dhe mësimdhënsit që të bashkëpunojnë me personin në fjalë.

KOMUNA RAHOVEC

Drejtoria Komonale për Arsim
Adresa: Xhelal Hajda – Toni p.n. Rahovec, Kosovë
Tel: +381 29 276 943
<http://kk.rks-gov.net/rahovec>

